



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

# ► PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT PËR HETIMIN DHE GJYKIMIN E RASTEVE TË SHFRYTËZIMIT TË FËMIJËVE NË FORMA TË RREZIKSHME TË PUNËS

Përgaditur nga:  
Dr. Ariana Qosaj-Mustafa, konsulente

- ▶ **PROCEDURAT STANDARDE  
TË VEPRIMIT PËR HETIMIN  
DHE GJYKIMIN E RASTEVE TË  
SHFRYTËZIMIT TË FËMIJËVE NË  
FORMA TË RREZIKSHME TË PUNËS**

## ► FALËNDERIME

---

Ky dokument është pjesë e projektit projektit “Masat, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përshejtimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar (MAP 16)” në mbështetje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) Caku 8.7. Fondet janë mundësuar nga Departamenti i Punës i SHBA-së në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me numër IL-30147-16-75-K-11. 100% e të gjitha shpenzimeve të projektit financohen nga fondet federale, në vlerë prej 22,4 million dollarësh, prej të cilave \$198,960 janë alokuar për aktivitetet në Kosovë.

Ky material nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose politikat e Departamentit të Punës të Shteteve të Bashkuara, dhe as përmendja e emrave tregtarë, produkteve komerciale ose organizatave nuk nënkupton miratimin nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara.

► **TABELA E PËRMBAJTJES:**

► <b>SHKURTESAT</b>	<b>7</b>
► <b>KAPITULLI I. KUPTIMI I FORMAVE TË RREZIKSHME TË PUNËS SË FËMIJËVE, SIPAS STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE DHE LEGJISLACIONIT NË KOSOVË</b>	<b>8</b>
► 1. HYRJE	9
► 2. PËRKUFIZIMET SIPAS STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE SI DHE LEGJISLACIONIT NË KOSOVË	10
► 3. SHKAQET E PUNËS SË FËMIJËVE DHE FORMAT MË PREVALENTE NË KOSOVË	19
► 4. PËRKUFIZIMET RELEVANTE PËR HETIMIN, PËRNDJEKJEN PENALE SI DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE VIKTIMA NGA PUNËT E RREZIKSHME SIPAS LEGJISLACIONIT VENDOR	20
► 5. KONCEPTET KRYESORE TË QASJES NË DREJTËSI SI DHE PARIMI I INTERESIT MË TË MIRË TË FËMIJËVE	22
► <b>KAPITULLI II. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE NË REAGIMIN NDAJ FORMAVE TË RREZIKSHME TË PUNËVE TË FËMIJËVE</b>	<b>24</b>
► 1. QËLLIMI I PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT NË HETIMIN DHE GJYKIMIN E FORMAVE TË RREZIKSHME TË PUNËS SË FËMIJËVE	25
► 2. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E SISTEMIT TË DREJTËSISË DHE AKTERËVE KYÇ NË REAGIMIN NDAJ RASTEVE TË FËMIJËVE VIKTIMA TË PUNËVE TË RËNDA	26
► 3. PALËT E TJERA NË PËRKRAHJE TË VIKTIMAVE FËMIJË	32
► <b>KAPITULLI III. MBROJTJA E VIKTIMAVE FËMIJË NGA PUNËT E RREZIKSHME</b>	<b>34</b>
► 2. TË DREJTAT E PËRKUFIZUARA NË LEGJISLACION LIDHUR ME MBROJTJEN E FËMIJËVE VIKTIMA	37
► <b>SHTOJCAT:</b>	<b>41</b>
► <b>Shtojca 1</b>	<b>42</b>
► Tabela e PSV-ve për reagimin në rastet e rrezikshme të punës së fëmijëve	42
► <b>Shtojca 2</b>	<b>48</b>
► Mekanizmat dhe ko-ordinimi ndërinstucional	48
► <b>BURIMET E CITUARA DHE BURIMET SHITESË</b>	<b>49</b>

► **SHKURTESAT**

► <b>ILO</b>	Organizata Ndërkombëtare e Punës
► <b>KP</b>	Kodi Penal
► <b>KPK</b>	Kodi i Procedurës Penale
► <b>KDM</b>	Kodi i Drejtësisë për të Mitur
► <b>MV</b>	Mbrojtësi i Viktimave
► <b>MFPT</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
► <b>QPS</b>	Qendra për punë sociale
► <b>PSV</b>	Procedurat Standarde të Veprimit
► <b>UA</b>	Udhëzim Administrativ

## ► KAPITULLI I

### KUPTIMI I FORMAVE TË RREZIKSHME TË PUNËS SË FËMIJËVE, SIPAS STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE DHE LEGJISLACIONIT NË KOSOVË

## 1. Hyrje

Përkufizimet sipas standardeve ndërkombëtare si dhe standardeve të drejtave të njeriut, obligojnë sistemin e drejtësisë në Kosovë, në zbatimin e tyre të drejtëpërdrejtë dhe në rast të konfliktit të mundshëm me dizpozitat e brendshme ligjore kanë përparësi ndaj tyre.<sup>1</sup> Kuptimi i formave të rrezikshme të punës së fëmijëve, poashtu i nënshtrohet një standardi të tillë dhe duhet të mirren parasysh nga sistemi i drejtësisë gjatë hetimit dhe gjyqimit të rasteve në përputhje me kërkesat e Kushtetutës së Kosovës.<sup>2</sup> Këto akte ndërkombëtare janë në fuqi nën legjislacionin kombëtar të Kosovës me anë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës tek “Zbatimi i drejtëpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare” (Neni 22). Pjesa kryesore e legjislacionit të brendshëm është përputhur me këto kërkesa të standardeve ndërkombëtare si dhe të drejtave të njeriut. Andaj përshkrimi më tutje ofron një analizë të tillë, duke nisur nga standardet ndërkombëtare të aplikueshme në përkufizimin e punës së rrezikshme të fëmijëve, zbatimin e tyre në kornizën ligjore të Kosovës dhe duke u fokusuar në viktimën fëmijë për të garantuar një qasje të bazuar me viktimën në qendër. Poashtu kërkohet që, për të ofruar zgjidhje afatgjatë të rasteve me viktimën në qendër, të garantohet qasje në sistemin e drejtësisë nga aspekti i drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijës në veçanti.

Përmbajtja e dokumentit të Procedurave Standarde të Veprimit për hetimin dhe gjykimin e rasteve të shfrytëzimit të fëmijëve në forma të rrezikshme të punës, është hartuar poashtu në përputhje me analizën e ndërmarrë në vitin 2021, nga ana e Akademisë së Drejtësisë në Kosovë në bashkëpunim me projektin “MAP ‘16”<sup>3</sup> financiar nga Departamenti i Punës i SHBA-së dhe menaxhuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës. Analiza përkatëse “Identifikimi dhe hetimi i rasteve të fëmijëve në punë: Sfidat e Sistemit të Drejtësisë,”<sup>4</sup> si modul trajnimi për prokurorë dhe gjyqtarë, në mes tjerash identifikon edhe analizën e kornizës ligjore si dhe akteve juridike relevante. Për më tepër projekti “MAP ‘16” në bashkëpunim edhe me Akademinë e Drejtësisë, në bazë të rekomandimeve në trajnimin e mbajtur me gjyqtarë dhe prokurorë të datës 26 shkurt 2021 në Prishtinë ka identifikuar nevojën për hartimin e Procedurave Standarde të Veprimit për hetimin dhe gjykimin e rasteve të fëmijëve viktima të punës së rrezikshme. Vlen të ceket se dokumenti në fjalë duhet të përdoret së bashku me dokumentin e Procedurave Standarde të Veprimit, si pako trajnuese për gjyqtar dhe prokuror dhe Mbrojtësit e Viktimave në përputhje me qasjen multidisciplinare për hetimin dhe gjykimin e rasteve të shfrytëzimit të fëmijëve në forma të rrezikshme të punës.

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, Neni 22.

<sup>2</sup> Shih Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, Neni 22.

<sup>3</sup> Projekti “Masat, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përsheptimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar (MAP 16)” financohet nga Departamenti i Punës i SHBA-së dhe menaxhohet nga Organizata Ndërkombëtare e Punës përkrahur nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës.

<sup>4</sup> Shih Modulin e Trajnimit për Prokurorë dhe Gjyqtarë hartuar për ILO dhe Akademinë e Drejtësisë nga trajnuesi: Prof/ Ass. Dr. Bedri Bahtiri, Prishtinë 2021.

## 2. Përkufizimet sipas standardeve ndërkombëtare si dhe legjislacionit në Kosovë

Analiza mëposhtë ofron shpjegimin kryesor lidhur me kornizën ligjore aktuale, aktet juridike relevante ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës kundër punës së rrezikshme, përfshirë këtu edhe legjislacionin ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si bazë për identifikimin dhe hetimin e këtyre rasteve në bazë të standardeve ndërkombëtare. Këto akte juridike ndërkombëtare kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve nga format më të rënda të punës së fëmijëve, me theks në format e rrezikshme të punës.

### Aktet juridike ndërkombëtare relevante:

- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Karta Sociale Evropiane;
- Pakti Ndërkombëtar Mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës;
- Konventa e ILO-s Nr.29 për Punën e Detyruar;
- Protokolli P029 i ILO-s për Konventën Nr.29 për Punën e Detyruar (2014);
- Konventa e ILO-s Nr. 138 për Moshën minimale të pranimit në punë;
- Konventa e ILO-s Nr. 182 për Format më të rënda të punës së fëmijës;

### Konventa Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

Konventa Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut,<sup>5</sup> ndalon punën e detyruar ose të detyrueshme, nën Nenin 4, (Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar), alinea 2. Kjo dispozitë nuk definon kuptimin e punës së detyruar ose të detyrueshme, por liston disa nga punët që përjashtohen si punë e detyruar dhe e detyrueshme. Konventa Evropiane thekson se “punë e kryer me dhunë ose e detyruar” nuk përfshin:

- a. çdo lloj pune që i kërkohet të kryejë zakonisht një personi të ndaluar në kushtet e parashikuara nga neni 5 i kësaj Konvente ose gjatë lirit të tij me kusht;
- b. çdo lloj shërbimi i karakterit ushtarak ose, në rastin e kundërshtarëve të ndërgjegjes në vendet ku kundërshtimi i ndërgjegjes është i njohur me ligj, shërbimi që kryhet në vend të shërbimit ushtarak të detyrueshëm;
- c. çdo lloj shërbimi që kërkohet në rast krizash ose fatkeqësish, që kërcënojnë jetën ose mirëqenien e bashkësisë;
- d. çdo lloj pune ose shërbimi që është pjesë e detyrimeve normale qytetare.”

Kjo konventë është në fuqi nën legjislacionin kombëtar të Kosovës me anë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës tek Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare (Neni 22), alinea (2). Gjykatat me rastin e marrjes së vendimeve mund të marrin parasysh këto përkufizime ndërkombëtare në arsyetimet e rasteve të hetuara dhe gjykuara.

<sup>5</sup> Shih Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e ndryshuar nga Protokollet Nr. 11, 14, dhe 15, 4 Nëntor 1950, gjendet në: [https://www.echr.coe.int/documents/convention\\_sqi.pdf](https://www.echr.coe.int/documents/convention_sqi.pdf).

### Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike,<sup>6</sup> është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1966 dhe në fuqi nga viti 1976. Pakti në fjalë, rregullon se askush nuk duhet të kryej punë të detyruar ose të detyrueshme, ndërsa përjashton vetëm rastet kur puna e detyruar është e karakterit ushtarak, burgimit apo në formë të detyrimeve qytetare normale (Neni 8). Pakti në pyetje po ashtu cek se fëmijët mund të përfitojnë nga masa mbrojtëse të caktuara nga familja, shoqëria apo shteti pa dallim race, gjinie, seksi, feje, origjinë kombëtare (Neni 24). Vlen të rikeket se masat mbrojtëse të cilat lëshohen nga institucionet përgjegjëse përfshirë këtu edhe gjykatat, mund dhe duhet të ndërmarrin masa mbrojtëse proaktive për të mbrojtur fëmijët pa dallim gjinie, statusi, feje, etj. Ky pakt është në fuqi nën legjislacionin kombëtar të Kosovës listuar në mënyrë taksative tek pjesa e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare direkt të aplikueshme në Kosovë sipas Nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës tek Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare (Neni 22), alinea 3.

### Karta Sociale Evropiane

Karta Sociale Evropiane,<sup>7</sup> rregullon dhe liston disa nga parimet dhe të drejtat ndërkombëtare që do të ndjeken nga shtetet palë, ku dhe theksohen mbrojtja e fëmijëve nga puna e dëmshme, mosha minimale e punësimit si dhe përcaktohen format e angazhimit të fëmijëve në punë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Pika e parë në Kartën Sociale Evropiane cek se “Cilido do të këtë mundësinë të fitojë jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht” (Pjesa 1, alinea 1). Po ashtu ceket se “Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për mbrojtje të veçantë ndaj rreziqeve fizike dhe morale ndaj të cilave ata ekspozohen” (alinea 2).

Ndërsa Karta Sociale Evropiane, për rregullimin dhe sigurimin e implementimit të së drejtës së fëmijëve për mbrojtje në Nenin 7, obligon shtetet anëtare sipas detyrimeve të listuara më poshtë:

- Mosha minimale për punë të caktohet mosha 15 vjeç me përjashtim punën e lehtë dhe që përcaktohet e padëmshme për moralin, shëndetin dhe arsimimin e fëmijëve;
- Të caktohen masa se mosha minimale për punësim të jetë 18 vjeç për punët që përcaktohen të dëmshme dhe të rrezikshme;
- Të caktohen masa që ndalojnë punën e fëmijëve në punë të cilat iu kufizojnë përfitimet nga arsimit teksa janë ende duke vijuar arsimin obligativ;
- Të kufizohet orari i punës për personat deri në moshën 18 vjeç;
- Të njohin të drejtën e punëtorëve të rinj për rrogë apo shpërblime të përshtatshme;
- Të caktohen masa që të kenë të drejtë për katër javë pushim në vit për personat nën moshën 18 vjeçare;
- Të caktohen masa që ndalojnë punën e personave nën moshën 18 vjeçare gjatë natës;
- Të caktohen masa që personat nën moshën 18 vjeçare, që punojnë në punë të përcaktuara me ligj, të kenë kontrolla mjekësore;
- Të caktohen masa mbrojtëse ndaj rreziqeve morale dhe fizike, qofshin ato direkte apo indirekte, në të cilat mund të jenë të ekspozuar në punë fëmijët dhe të rinjtë.

<sup>6</sup> Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 16 dhjetor 1966, Kombet e Bashkuara, gjendet në: <https://hrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>.

<sup>7</sup> Këshilli i Evropës, Karta Sociale Evropiane, 18 tetor 1961, gjendet në: <https://rm.coe.int/168047e169>.

## Pakti Ndërkombëtar Mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

Pakti Ndërkombëtar Mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore<sup>8</sup>, është në fuqi dhe është adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në vitin 1976. Ky pakt në Nenin 10, parasheh se shtetet duhet të caktojnë masa për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga shfrytëzimi ekonomik dhe shoqëror, të caktohet mosha minimale për punësim, dhe po ashtu përcakton se punësimi i fëmijëve në punë që dëmton moralin, shëndetin, dhe zhvillimin normal të tyre, duhet të ndëshkohet nga shtetet palë (alineja 3).

## Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës

Një nga Konventat kyçe si dhe Konventat novatore në mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në veçanti, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës,<sup>9</sup> ka hyrë në fuqi në vitin 1989. Shtetet palë në bazë të kësaj Konvente njohin të drejtën e fëmijëve për mbrojtje nga shfrytëzimi ekonomik, dhe nga puna që dëmton arsimimin, shëndetin, zhvillimin fizik, mendor e moral të tyre (Neni 32, alineja 1). Konventa krijon obligim ndaj shteteve palë që të caktojnë moshë minimale për punësim, rregullimin e orarit të punës dhe kushteve të punës si dhe kërkohet nga shtetet të zbatojnë ndëshkime ligjore për të siguruar zbatimin e Nenit 32 (alineja 2). Poashtu si Konventë direkt e listuar në Nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me obligimet e institucioneve në zbatimin e marrëveshjeve dhe instrumenteve, mund të përdoret nga gjykatat në arsyetimet e veprimeve të ndërmarra në hetimin dhe gjykimin e rasteve të formave të rrezikshme të punës së fëmijëve.

8 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 16 dhjetor 1966, Kombet e Bashkuara, gjendet në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cescr.aspx>.

9 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, 20 nëntor 1989, Kombet e Bashkuara, gjendet në <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>.

10 Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Konventa e Punës së Detyruar Nr.29, 28 qershor 1930, gjendet në [https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100\\_ILO\\_CODE:C029](https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:C029).

## Konventa e ILO-s Nr.29 për Punën e Detyruar;

Konventa e ILO-s për Punën e Detyruar,<sup>10</sup> është miratuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës në vitin 1930, obligon shtetet ratifikuese të ndalojnë përdorimin e punës së detyruar ose të detyrueshme (Neni 1). Konventa në fjalë thekson se *“Termi punë e detyruar ose e detyrueshme do të thotë çdo punë ose shërbim që kërkohet nga çdo person nën kërcënimin e ndonjë dënimi dhe për të cilin personi në fjalë nuk është ofruar vullnetarisht”* (Neni 2). Pra, Konventa e ILO-s nr.29 definon termin punë e detyruar ose e detyrueshme, ku nuk specifikohet forma e ndëshkimit, qoftë fizike, verbale por vetëm se puna e detyruar është po ashtu shërbimi që vjen si pasojë e kërcënimit të ndonjë dënimi të çfarëdo forme dhe nuk është ofruar në mënyrë vullnetare. Vlen të ceket se standardet e krijuara të të drejtave të njeriut për mbrojtje nga puna e detyruar e kanë zanafillën në këtë konventë që më vonë amandamentohet nga Protokollin i ILO-së Nr.029 për Punën e Detyruar (2014).

►► Konventa e ILO-s për Punën e Detyruar është miratuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës në vitin 1930, obligon shtetet ratifikuese të ndalojnë përdorimin e punës së detyruar ose të detyrueshme (Neni 1).

## Protokollin I ILO-së Nr.029 për Punën e Detyruar (2014)

Amandamenti i Konventës së ILO-s Nr.29 për Punën e Detyruar<sup>11</sup>, është rregulluar me anë të Protokollit shtesë të kësaj Konvente në vitin 2014 nga Organizata Ndërkombëtare e Punës. Protokollin në fjalë njihet rolin e rëndësishëm që ka krijuar Konventa e Punës së Detyrueshme, 1930 (Nr. 29), në luftën kundër punës së detyruar, por cek se nevojiten masa shtesë për të u siguruar zbatimin efektiv i dispozitave të Konventës. Protokollin thekson se shtetet palë të Konventës nr.29 të ILO, janë të obliguar të marrin masa efektive për të ndaluar punën e detyruar duke përfshirë mjete juridike dhe kompensim për viktimat, ndërsa si më të rëndësishme parasheh që shtetet palë duhet të sanksionojnë dhe përndjekin kryesit e punës së detyruar (Neni 1). Në veçanti pra gjykatat duhet të veprojnë në mënyrë që të mos vazhdohet me mos-ndëshkimin e kryesve të këtyre veprave ndaj viktimave fëmijë dhe të ndërprehet pandëshkueshmëria e kryesve.

►► Amandamenti i Konventës së ILO-s Nr.29 për Punën e Detyruar<sup>12</sup>, është rregulluar me anë të Protokollit shtesë të kësaj Konvente në vitin 2014 nga Organizata Ndërkombëtare e Punës.

11 Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Protokollin Konventës së Punës së Detyruar P029, 2014, gjendet në [https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100\\_INSTRUMENT\\_ID:3174672](https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_INSTRUMENT_ID:3174672).

12 Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Protokollin Konventës së Punës së Detyruar P029, 2014, gjendet në [https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100\\_INSTRUMENT\\_ID:3174672](https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_INSTRUMENT_ID:3174672).

13 Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Konventa për Moshën Minimale të Pranimit në punë Nr.138, Qershor 1973, gjendet në [https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=1000:12100:0::NO::P12100\\_ILO\\_CODE:C138](https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=1000:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:C138).

14 Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Konventa për Format më të rënda të punës së fëmijëve Nr.182, 1999, gjendet në [https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO:12100:P12100\\_ILO\\_CODE:C182:NO](https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO:12100:P12100_ILO_CODE:C182:NO).

## Konventa e ILO-s Nr. 138 për Moshën minimale të pranimit në punë

Konventa e ILO-s për Moshën Minimale<sup>13</sup> është miratuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës në vitin 1973, parasheh se shtetet anëtare duhet të caktojnë moshën minimale për punësim në përshtatshmëri me zhvillimin fizik dhe mendor të të rinjve (Neni 1). Përcakton se mosha minimale e caktuar nuk mund të jetë nën moshën 15 vjeçare (Neni 2, alineja 3). Ndërsa për punësimin i cili dëmton shëndetin apo moralin e personit, mosha minimale nuk mund të caktohet nën moshën 18 vjeçare, përjashtimisht nëse sigurohet se nuk do të cenohet mirëqenia e të riut atëherë lejohet të caktohet mosha minimale e punësimit të jetë 16 vjeçare (Neni 3). Kjo sigurohet vetëm kur autoritetet kompetente të nivelit nacional, konsultohen me organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve, dhe po ashtu thekson se është kusht që shëndeti, siguria dhe morali i të rinjve nuk do të cenohen, dhe që të rinjtë në fjalë të marrin udhëzime specifike ose trajnime në degën përkatëse të veprimtarisë (Neni 3).

## Konventa e ILO-s Nr. 182 për Format më të rënda të punës së fëmijëve;

Konventa për Format më të rënda të punës së fëmijëve<sup>14</sup> është adoptuar në vitin 1999 nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), dhe definon format më të rënda të punës së fëmijëve dhe cek disa masa për zbatimin efektiv për mbrojtjen ndaj punës së rëndë të fëmijëve që duhet të ndërmerren nga shtetet. Konventa në Nenin 3 definon se format më të rënda të punës së fëmijëve janë:

- Të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë, si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, puna e detyruar ose e detyrueshme;

- Përdorimi ose ofrimi i një fëmije për prostitucion, pornografisë ose për shfaqje pornografike;
- Përdorimi ose ofrimi i një fëmije për aktivitete të paligjshme, veçanërisht për prodhimin dhe trafikimin e drogës;
- Punë e cila, nga natyra e saj ose nga rrethanat në të cilat kryhet, ka të ngjarë të dëmtojë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijës.

Konventa nr.182 obligon shtetet palë të marrin masa për të siguruar zbatimin efektiv të dispozitave të Konventës për mbrojtjen e fëmijëve nga format më të rënda të punës së fëmijëve duke përfshirë sanksione penale dhe sanksione të përshtatshme (Neni 7). Po ashtu specifikon se secili shtet anëtarë, duhet të marrë parasysh impaktin e edukimit për parandalimin dhe eliminimin e punës së rëndë të fëmijëve (Alinea 2). Neni 7, alinea 2 po ashtu cek se shtetet anëtare duhen të parandalojnë punën e rëndë të fëmijëve, ofrojnë ndihmë direkte për largimin e fëmijëve nga puna e rëndë, integrimin shoqërorë të fëmijëve si dhe të sigurohen se fëmijët kanë akses në arsimim.

## Aktet juridike për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji nr. 03/L-212 i Punës;
- Ligji nr. 2004/32 i Kosovës për Familjen dhe Ligji nr.06/L-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen;
- Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e fëmijës;
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës (2019);
- Kodi i Drejtësisë për të mitur;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Menjëhershëm të Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve.

<sup>15</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 28 paragrafi 2

<sup>16</sup> Ligji nr. 03/L-212 i Punës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/01, Dhjetor 2010

## Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Kosovës ndalon punën e detyruar dhe përmban dispozita për mbrojtjen e mirëqenies së fëmijëve. Neni 28 i Kushtetutës thekson se:

*"Askush nuk mund të shtrëngohet për të kryer punë të detyruar. Punë e detyruar nuk*

*konsiderohet puna ose shërbimi i përcaktuar me ligj për personat e dënuar me vendim të*

*formës së prerë gjatë vuajtjes së dënimit ose në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, të*

*shpallur sipas rregullave të përcaktuara me këtë Kushtetutë."*<sup>15</sup>

Po ashtu, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi dhe gëzojnë të drejtën e të kujdesurit për mirëqenien e tyre (Neni 50). Me këto dispozita Kushtetuta rregullon ndalimin e punës së detyruar dhe njëkohësisht obligon mbrojtjen e eksploatimit të fëmijëve dhe kërkon kujdes të shtuar nga ana e institucioneve përgjegjëse për të mirën e fëmijëve.

## Ligji i Punës (Nr. 03/L-212)

Ligji i punës<sup>16</sup> rregullon kushtet dhe kriteret e themelimit të marrëdhënies së punës brenda territorit të Kosovës në Nenin 7, ku ceket se personat mbi moshën 18 vjeçare mund të hyjnë në marrëdhënie pune. Moshë minimale për të hyrë në marrëdhënie punë është mosha 15 vjeçare, vetëm nëse puna nuk është jashtëligjore dhe përcaktohet me ligj nga natyra si punë e lehtë në këtë rast kur nuk paraqet rrezik për mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës (Neni 7, alinea 2). Po ashtu, ligji i Punës, ndalon punën e natës për persona nën moshën 18 vjeçare (Neni 27, alinea 3). Me këto dispozita rregullohet se cila punë është e përshtatshme për fëmijë dhe se puna e rëndë është e ndaluar për fëmijët pasi që puna e vetme që lejohet të kryhet nga persona nën moshën 18 vjeçare, është puna e lehtë dhe e parrezikshme për mirëqenien e fëmijës.

## Ligji për Familjen (nr. 2004/32)

Ligji për Familjen<sup>17</sup>, si dhe Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen<sup>18</sup> parashtrojnë kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënieve prindër-fëmijë si dhe marrëdhëniet familjare. Në Ligjin për Familjen nr.2004/31, po ashtu ceken përgjeggjësitë e prindërve ndaj fëmijës, të drejtat e fëmijëve dhe detyrimet ndaj prindërve. Ligji i Familjes thekson se "Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga shfrytëzimi ekonomik, eksploatimi i fëmijëve, trafikimi dhe eksploatimi seksual dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rrezik ose që cenon edukimin ose dëmton shëndetin e tyre" (Neni 125, alinea 5).

Përgjeggjësia prindërore dhe obligimet ndaj fëmijëve nga prindi rregullohen me Nenin 128, ku thekson se fëmija është nën përgjeggjësinë prindërore deri në moshën madhore (alinea 2), dhe prindërit obligohen me ligj nga alinea 3 që të sigurojnë parimet për mbrojtjen e fëmijëve në Nenin 125, ku përfshihet edhe mbrojtja nga eksploatimi. Po ashtu, ceket se prindërit kanë për detyrë të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale (Neni 128, alinea 4). Kjo vijon se sigurimi i mirëqenies së fëmijës duhet të konsideron dhe merr parasysh aftësitë dhe dëshirat e fëmijës në fjalë. Po ashtu ligji në fjalë cek, se nga mosha 15 vjeçare fëmija është i detyruar të ndaj financiarisht të ardhurat nga puna e tij/saj, për mbajtjen e vetes apo dhe të kontriboj për familjen nëse e kërkon nevoja (Neni 292). Duhet ta rikeket pra se puna e lejuar, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës që shprehin se personi mund të punojë nga mosha 15 vjeçare e tutje vetëm nëse puna në fjalë është punë e lehtë dhe nuk paraqet rrezik për mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës (Ligji I Punës Nr. 03/L-212, Neni 7, alinea 2).

<sup>17</sup> Ligji nr. 2004/32 për Familjen, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 4/01, Shtator 2006

<sup>18</sup> Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit për Familjen, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 3/17, Janar 2019.

<sup>19</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 2/14 Janar 2019.

<sup>20</sup> Neni 108, alinetë 1.27-1.31 të Kodit Drejtësisë për të mitur.

## Kodi Penal i Republikës së Kosovës

Kodi Penal i Kosovës<sup>19</sup> rregullon sanksionet në lidhje me punën e detyruar në Nenin 163 "Skllavëria, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe puna e detyruar". Parasheh se personi i cili blen apo shet dikë në punë të detyruar, përfshirë mohimin e fryteve të punës, shtrëngimin e personit për të punuar apo ja cenon lirinë e personit për të ndryshuar kushtet e punës, dënohet me gjobë dhe burgim nga 2 deri në 10 vjet (Neni 163, alinea 1). Kodi Penal po ashtu thekson se kushdo që shkel Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut si në kushtet e lartëcekura, dënohet nga 2 deri 10 vjet, ndërsa nëse shkelja ndodh ndaj një personi që ka marrëdhënie familjare, dënimi ngritet nga 3 deri në 10 vjet (Neni 163, alinea 2 dhe 3). Kodi Penal po ashtu parasheh se kushdo që shkel dispozitat ndërkombëtare ndaj mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në kontekst të punës së detyruar, burgoset nga 3 deri në pesëmbëdhjetë vjet (Neni 163, alinea 4).

## Kodi i drejtësisë për të mitur

Kodi i Drejtësisë për të mitur mes tjerash përkufizon fushëveprimin e vet edhe në mbrojtjen e e personave të mitur dhe fëmijëve të cilët janë viktimë dhe të dëmtuar nga vepra penale. Kodi i drejtësisë për të mitur poashtu përkufizon dispozitat ligjore lidhur me mbrojtjen e fëmijës si viktimë në procedurë penale, në veçanti lidhur me rastet që lidhen me punët e rënda/ rrezikshme të fëmijëve sikurse keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës; shkelja e detyrimeve familjare; shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës; si dhe mosraportimi i abuzimit të fëmijëve.<sup>20</sup>



## Ligji për Mbrojtjen e fëmijës (Nr. 06/L-084)

Ligji për Mbrojtjen e fëmijës<sup>21</sup> është miratuar në vitin 2019 dhe ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2020. Ligji në fjalë ka për qëllim mbrojtjen e fëmijës të harmonizuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës dhe akteve ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve. Ligji për Mbrojtjen e fëmijës thekson se puna e cila lejohet për fëmijën nuk duhet të cenojë mirëqenien fizike, mendore, të drejtën për arsimim, kohë të lirë dhe lojë (Neni 49). Për më tepër, përcakton se punësimi i fëmijës duhet të monitorohet nga Inspektorati i Punës, për të siguruar sigurinë dhe kushtet e punës (alineja 3). Ligji për mbrojtjen e fëmijës rregullon moshën minimale të fëmijës për punësim duke ndaluar angazhimin në punësim të personave nën moshën minimale. Neni 50 parasheh "Asnjë punëdhënës nuk mund të punësojë dhe lidhë kontratë pune me ndonjë fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç" (alineja 2). Për më tepër ligji përcakton se puna e lejuar për fëmijë është vetëm ai aktivitet ekonomik që nuk është i dëmshëm dhe nuk cenon arsimimin apo kohën e lirë të fëmijës, ndërsa puna e ndaluar është cdo lloj aktiviteti që dëmton sigurinë, shëndetin, moralin dhe gjendjen fizike të fëmijës (Neni 3). Poashtu ligji parasheh që fëmija mund të punësohet vetëm në aktivitete ekonomike që nuk janë të dëmshme për zhvillimin dhe shëndetin e fëmijës, posaçërisht nuk i pengojnë që të vijojnë shkollimin dhe shfrytëzimin e kohës së lirë, si dhe nëse ajo punë nuk është e ndaluar me legjislacionin në fuqi. E lejuar është edhe puna e cila është pjesë e praktikës profesionale dhe nën mbikëqyrjen përkatëse, pasi të jenë evidentuar dhe eliminuar të gjitha rreziqet. Për pagesën e kontributeve pensionale, punëdhënësi është i detyruar që fëmijën e punësuar ta lajmërojë në Administratën Tatimore të Kosovës, institucionet e tjera të cilat i menaxhojnë dhe administrojnë skemat e obligueshme pensionale dhe të tjera.

Poashtu ligji parasheh se në nënin 59, se fëmijët viktimë të cilat i janë nënshtruar punës së fëmijëve që nuk është në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi i ofrohet ndihmë mjekësore dhe psikologjike, masa rehabilituese dhe riintegruese, ndihmë juridike dhe të drejtën për kompensim në pajtim me ligjin për kompensimin e viktimave të krimit.

## Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Menjëhershëm të Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve.

Ky Udhëzim Administrativ përcakton format e rrezikshme të punës së fëmijëve, dhe obligon institucionet përgjegjësi për parandalimin dhe monitorimin e formave të rrezikshme të punës me qëllim që të ndalohen format e rrezikshme të punës së fëmijëve. Neni 4 shpreh se cdo lloj forme e listuar në Aneksin e Udhëzimit Administrativ ndalohet rreptësisht dhe kërkohet intervenim të menjëhershëm. Përjashtimet e kësaj dispozite janë të theksuara si më tutje:

*"Çdo punë e fëmijës, e paguar apo e papaguar, punë vullnetare, formë e masave alternative ndaj të miturve në konflikt me ligjin, punësi pjesë e praktikës profesionale apo çfarëdo lloj angazhimi tjetër ekonomik i fëmijës, mund të lejohet vetëm në bazë të lejes së prindit, kujdestarit apo të organit të kujdestarisë, nën mbikëqyrjen përkatëse dhe pas një vlerësimi të dokumentuar të rreziqeve dhe masave për menaxhimin e rreziqeve të cilave mund t'u ekspozohet fëmija"* (Neni 5). Pra, çdo punë e fëmijës duhet të bëhet nën mbikëqyrjen e organeve kompetente dhe pasi që vlerësohen rreziqet dhe mënyra se si mund të mbrohet fëmija ndaj ekspozimit të këtyre rreziqeve, pra nuk mjafton vetëm leja e prindit apo kujdestarit ligjor. Për më tepër secili rast i cili identifikohet se merr pjesë në ndonjë nga format e rrezikshme të punës për fëmijë, duhet të i paraqitet Qendrës për Punë Sociale (Neni 6, alineja 4). Ky Udhëzim obligon edhe Organin e Kujdestarisë të inicioj procedurë për kundërvajtje apo kallëzim penal nëse detyrohen fëmijët të kryejnë punë të vlerësuar si formë e rrezikshme e punës për fëmijë (Neni 7). Poashtu Neni 6 alineja 3 e këtij Udhëzimi Administrativ obligon autoritetet komunale që t'i përcaktojnë procedurat standarde të veprimit për monitorimin e punës së fëmijëve si proces i identifikimit, vlerësimit, tërheqjes dhe mbrojtjes së fëmijëve nga format e rrezikshme të punës.

<sup>21</sup> Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.14/17, Korrik 2019

## Lista e Aktiviteve të përgjithshme dhe sektorëve me prioritet të cilat ndalohen sipas UA Nr. 05/2013:

**(A) Aktivitetet e përgjithshme për ndalim të menjëhershëm për fëmijët deri në moshën 18 vjeç, përfshijnë:**

- 1 Puna e natës, e cila sipas UA nr. 01/2012 ndalon punën e të rinjve prej orës 22 deri në 6 të mëngjesit. Për fëmijët që nuk kanë të themeluar marrëdhënie pune por janë të angazhuar në aktivitete të ndryshme që kanë për qëllim përfitim ekonomik, me prioritet ndalohet puna e natës ndërmjet orës 20:00 deri më 06:00;
- 2 Ngritja dhe bartja e kohëpaskohshme e peshave të rënda mbi 15 kg (M) dhe 10 kg (F);
- 3 Ngritja dhe bartja e vazhdueshme e peshave mbi 10 kg (M) dhe 5 kg (F);
- 4 Puna në thellësi, nën sipërfaqe të tokës, nën ujë dhe vende të mbyllura;
- 5 Puna në lartësi mbi 2 m;
- 6 Ekspozimi ndaj temperaturave ekstreme të larta apo të ulëta, ndaj zhurmës dhe dridhjes;
- 7 Ekspozimi ndaj substancave toksike,
- 8 Ekspozimi ndaj substancave biologjike
- 9 Ekspozimi ndaj radioaktivitetit;
- 10 Ekspozimi ndaj substancave kancerogjene, pluhurit dhe gazrave.

**(B) Sektorët për ndalim të menjëhershëm për fëmijët deri në moshën 18 vjeç, dhë të përcaktuara si prioritet nga ana e Qeverisë sipas UA Nr.05/2013 janë:**

- 1 Bujqësia dhe pylltaria;
- 2 Puna në rrugë;
- 3 Puna në ndërtimtari;
- 4 Puna në deponi të mbeturinave;
- 5 Puna në eksploatimin e pasurive natyrore.

Udhëzimi Administrativ Nr.03/2013 poashtu ka përcaktuar format më prevalente të shfrytëzimit të fëmijëve në Kosovë, duke kërkuar reagim të menjëhershëm institucional. Sipas UA Nr.03/2013 aktivitetet e rrezikshme të cilat kanë prevalencë në Kosovë dhe duhet të kenë prioritet në reagim janë:

- a. Operimi me makina bujqësore;
- b. Puna me pesticide dhe spërkatja;
- c. Korrjet;
- d. Punë të rënda fizike në fusha dhe hapja e gropave për pyllëzim ose mbjellje të pemëve;
- e. Prerja e druve dhe përpunimi i drurit;
- f. Puna në thertore dhe në industrinë e përpunimit të mishit (prerja, transporti dhe shitja e kafshëve);
- g. Gjuetia;
- h. Grumbullimi i frutave malorë dhe vjelja e pemëve;
- i. Puna në serrë;
- j. Puna në bletishte;
- l. Bartja e peshave të rënda;
- m. Pastrimi i parafangove të automjeteve në komunikacion;
- n. Transporti i mallrave me karrocë bartëse;
- o. Kërkimi i lëmshës;
- p. Gërmimi i dheut;
- q. Transportimi i peshave të rënda;
- r. Sitja e rërës dhe çimentos;
- s. Puna në skela;
- t. Përpunimi i metaleve;
- u. Puna në deponi të mbeturinave;
- v. Hulumtimi, grumbullimi dhe bartja e mbeturinave si dhe
- x. puna në eksploatimin e pasurive natyrore.

## 3. Shkaqet e punës së fëmijëve dhe format më prevalente në Kosovë

Shkaqet e përfshirjes së fëmijëve në punë të rrezikshme në Kosovë janë identifikuar në një sërë dokumentesh të hartuara nga ish-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, tani Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). Në veçanti dy dokumente bazë "Udhëzuesi për Menaxhimin e Rasteve të Fëmijëve në Punë," si dhe "Procedurat Standarde të Veprimit për fëmijë në forma të rrezikshme të punës," hartuar nga MFPT identifikojnë këto shkaqe të natyrës së ndryshme. Në mes tjerash, identifikohen një sërë arsyesh që shtyejnë fëmijët në punë të rrezikshme duke qenë faktori më i rëndësishëm *varfëria*. Varfëria dhe angazhimi i fëmijëve në punë të rrezikshme, konsiderohen edhe si rezultat i një "ekuilibri të ulët ekonomik" në familje, komunitet dhe nivel vendi.<sup>22</sup> Për më tepër, përveç varfërisë, ekzistojnë edhe faktorë të tjerë që kontribuojnë në punën e fëmijëve, përfshirë qëndrimin mbështetës ndaj punës së fëmijëve ku prindërit por edhe shoqëria në përgjithësi e shohin punën e fëmijëve si pjesë e edukimit të fëmijëve dhe e konsiderojnë si fenomen "normal" të përballjes me varfërinë, duke relativizuar rreziqet për fëmijët në punë të rrezikshme.<sup>23</sup> Prindërit poashtu mbështesin punën e fëmijëve si mënyrë për t'i mbajtur fëmijët e tyre të sigurt, në rajone ku disa fëmijë diskriminohen dhe i nënshtrohen dhunës në shkollë si për shembull fëmijët Romë në Evropë, duke mos qenë as Kosova përjashtim nga kjo situatë. Faktorë tjerë të identifikuar janë edhe mjedisi i çrregulluar familjar sikurse familjet me një prind; sëmundja e prindit apo paaftësia e personit të ngarkuar të familjes për të siguruar mirëqenien dhe për të ofruar detyrimet familjare në ushqim; varësia nga alkoholi ose droga; ambienti abuzues dhe ushtrimi i dhunës në familje, etj.

Në disa raste fëmijët detyrohen nga prindërit të punojnë në rrugë ose edhe vetë largohen nga shtëpia dhe punojnë në rrugë për shkak të ambientit të çrregulluar familjar (Ibid, 2020:10-20). Faktorë tjerë të identifikuar janë edhe mungesa e qasjes në arsim si p.sh largësia gjeografike e shkollave, diskriminimi dhe pritjet nga prindërit që fëmijët të kryejnë detyra specifike përderisa janë ende fëmijë dhe mosreagimi institucional ndaj fenomenit të martesave të hershme dhe të detyrueshme.<sup>24</sup> Bazë tjetër e diskriminimit është edhe gjinia ku ndarja me bazë gjinore e punës detyron vajzat dhe djemtë t'i kufizojnë perspektivat e punës së tyre sikurse vajzat që mund të detyrohen të qëndrojnë në shtëpi dhe të kryejnë punë që nuk kompensohen.<sup>25</sup> Poashtu shkak mund të jenë edhe kërkesa e bizneseve që të punësojnë fuqi më të lirë punëtore, që shpeshherë lidhet edhe me ekonominë joformale. Udhëzuesi në fjalë ka identifikuar edhe mungesën e kontratave në sektorin informal që vështirësojnë mbrojtjen e fëmijëve nga kushtet abuzive të punës dhe identifikimin e fëmijëve në punë. Kjo ndikon drejtpërdrejt edhe në prevalencën më të lartë të formave më të këqija të punës së fëmijëve, duke përfshirë këtu edhe veprimtaritë sikurse trafikimi me qenie njerëzore si dhe prostitucioni (nësee i kriminalizuar). (Ibid, 2020:19-20). Mirëpo edhe zbatimi i dobët i ligjit dhe sundimit të ligjit në veçanti ndikon në rritjen e angazhimit të fëmijëve në punë të rrezikshme.

22 Po aty faqe 19-21, shih "Udhëzuesi për Menaxhimin e Rasteve të Fëmijëve në Punë," 2020, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

23 Po aty, faqe 19-20.

24 Shih këtu publikimin përkrahur nga UNËOMEN në Kosovë dhe zbatuar nga Rrjeti i Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptas "Raporti mbi zbatimin e kërkesave të Konventës së Stambollit lidhur me situatën e martesave të hershme apo të detyrueshme në komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptas, 2019.

25 Supra note në 21.

## 4. Përkufizimet relevante për hetimin, përndjekjen penale si dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë nga punët e rrezikshme sipas legjislacionit vendor

**Fëmijët**- përkufizohen në Kodin e Drejtësisë për të Mitur si secili person i cili nuk ka mbushur 18 vjet.

**Viktima e ndjeshme**- Kodi Penal i Kosovës (2019) në mes tjerash përkufizon edhe viktimat e ndjeshme të cilëve ju ofrohet kujdes i shtuar në sistemin e drejtësisë penale. Sipas Kodit Penal viktimë e ndjeshme konsiderohet fëmiju, personi me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, personi me aftësi të zvogëluar, grua shtatzënë, i/e moshuar ose person marrëdhënia apo varësia e të cilit ndaj kryesit e bën atë veçanërisht të ndjeshëm ndaj viktimizimit të përsëritur, frikësimit të përsëritur apo hakmarrjes së përsëritur.<sup>26</sup>

**Puna e lejuar për fëmijë** – përkufizohet si pjesëmarrja e fëmijës në aktivitete ekonomike që nuk janë të dëmshme për zhvillimin dhe shëndetin e fëmijës, posaçërisht nuk i pengojnë që të vijnë shkollimin dhe shfrytëzimin e kohës së lirë. E lejuar është edhe puna e cila është pjesë e praktikës profesionale dhe nën mbikëqyrjen përkatëse, pasi të jenë evidentuar dhe eliminuar të gjitha rreziqet.<sup>27</sup>

**Puna e ndaluar për fëmijët**- është puna apo aktiviteti i cili dëmton sigurinë, shëndetin, moralin dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës, si rezultat i mungesës së përvojës dhe njohurive për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës.<sup>28</sup>

**Format e rrezikshme të punës së fëmijës** - janë punë që mund të rezultojnë me vdekje, lëndime apo sëmundje që mund të jenë shpeshherë permanente të fëmijës, si pasojë e mospërshtatjes së natyrës së punës me moshën dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës dhe sigurisë së pamjaftueshme në vendin e punës.<sup>29</sup>

**Mbrojtja e fëmijëve**: Sipas nenit 3 të Kodit të Drejtësisë për të mitur, alinea 1.7 mbrojtja e fëmijës - nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit

dhe neglizhimit, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës në dhe jashtë shtëpisë.

**Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës**- Kodi Penal përkufizon në Nenin 243 veprën penale të keqtrajtimit apo braktisjes së fëmijës nga prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër që ushtron autoritet prindëror mbi fëmijën, i cili keqtrajton fëmijën duke përdorur masa fizike apo mendore ose shkel detyrimin e tij për përkujdesje dhe edukim të fëmijës, dhe parasheh të dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet. Poashtu alinea 1.4 përkufizon që prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër që ushtron autoritet prindëror mbi fëmijën, i cili detyron fëmijën e tillë të punojë në mënyrë të tepruar ose të kryej punë që nuk është e përshtatshme për moshën e fëmijës ose e detyron fëmijën e tillë që në lëmshë të lyp para ose dobi tjetër materiale, ose e detyron fëmijën e tillë që të përfshihet në aktivitete që e rrezikojnë apo dëmtojnë zhvillimin e fëmijës, do të dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet. Në rast se vepra penale nga ky nen rezulton me dëmtim të rëndë të shëndetit mendor apo lëndim të rëndë të fëmijës, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet.

**Shkelja e detyrimeve familjare**- Kodi penal në Nenin 244 përkufizon se kushdo që shkel detyrimet e tij ligjore familjare, duke lënë në gjendje të rëndë anëtarin e familjes i cili nuk është në gjendje të kujdeset për vetën e tij, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet. Më tutje alinea 1.2 cek se kur vepra penale nga alinea 1. i këtij neni ka të bëjë me fëmijën, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Nëse vepra penale nga alinea 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e anëtarit të familjes apo me dëmtim të rëndë të shëndetit të tij, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

**Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës**- Kodi penal në nenin 245 përkufizon se kushdo që i shmanget sigurimit të mjeteve të jetesës për personin për të cilin është i detyruar të kujdeset në bazë të vendimit të plotfuqishëm të gjykatës, marrëveshjes së plotfuqishme gjyqësore ose vendimit të organit tjetër kompetent, me anë të shmangies së punësimit, raportimit të rrejshëm të punësimit apo të të ardhurave, ndërrimit të vendit të punës, ndërrimit të vendbanimit apo vendqëndrimit, tjetërsimit të pasurisë ose në ndonjë mënyrë tjetër i shmanget sigurimit të mjeteve të jetesës për personin e tillë, dënohet me burgim deri në një (1) vit. Poashtu alinea 1.3 cek se kur vepra penale nga alinea 1. i këtij neni ka të bëjë me fëmijën kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

**Mos raportimi i abuzimit të fëmijëve**- Kodi Penal parasheh përgjegjësi edhe për profesionistët detyrimin e paraqitjes së rastit të abuzimit të fëmijëve dhe në rast të mos raportimit parasheh sanksione penale. Për më tepër, neni 247 përkufizon se kushdo që ka arsye për të dyshuar se një fëmijë ka pësuar një incident të abuzimit, keqtrajtimit, braktisjes apo moskujdesit dhe nuk raporton menjëherë abuzimin ose moskujdesin, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. Në rast se vepra penale nga alinea 1. i këtij neni kryhet nga prindi, prindi adoptues apo kujdestari, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet (Shih alinea 1.2) Gjithashtu, kushdo që gjatë angazhimit profesional lidhur me fëmijën, ka arsye për të dyshuar se fëmija ka pësuar incident të abuzimit të fëmijës, keqtrajtimit, braktisjes apo moskujdesit ose ka qenë i nënshtruar ndaj dhunës apo kanosjes për përdorim të dhunës, dhe nuk e raporton menjëherë rastin, dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3)

vjet. Nëse vepra penale nga alinea 1., 2. ose 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e fëmijës apo me dëmtim të rëndë të shëndetit të tij, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet (alinea 1.4).

Përpos veprave penale dhe sanksioneve penale të paraqitura nga Kodi Penal, edhe Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, parasheh gjobë në shumë prej pesëqind (500) euro deri në njëzet mijë (20,000) euro për personat juridikë, personat përgjegjës ose organit me autorizime publike, për shkeljet e përcaktuara në nenet 50, 51, dhe 52 të këtij ligji, përfshirë rastet e shkeljes së punës së ndaluar të fëmijëve si edhe për veprimet sanksionuese me rastin e shkeljeve apo mosveprimit. Organi kompetent në kuadër Ministrisë përkatëse të Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe organi kompetent në kuadër të Ministrisë përkatëse të Punëve të Brendshme shqiptojnë gjobën në përputhje me legjislacionin në fuqi në shumë prej njëqind (100) euro deri në dy mijë (2,000) euro për personin fizik, për shkeljet e përcaktuara në nenet 50, 51, dhe 52 të këtij ligji, përfshirë edhe veprimet sanksionuese me rastin e shkeljeve apo mosveprimit. Organi kompetent në kuadër të ministrisë përkatëse të punës dhe mirëqenies sociale dhe organi kompetent në kuadër të Ministrisë përkatëse të Punëve të Brendshme shqiptojnë gjobën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

►► Mbrojtja e fëmijës - nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës në dhe jashtë shtëpisë.

<sup>26</sup> Neni 113, përkufizimet alinea 39.

<sup>27</sup> Ligji për mbrojtjen e fëmijës, Neni 3, alinea 1.12.

<sup>28</sup> Po aty, Neni 3, alinea 1.13.

<sup>29</sup> Po aty, Neni 3, alinea 1.14.

## 5. Konceptet kryesore të qasjes në drejtësi si dhe parimi i interesit më të mirë të fëmijëve

Konceptet kryesore të qasjes së punës me fëmijë bazohen në parimet ekzistuese të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe në veçanti në “Udhëzuesin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës lidhur me drejtësinë miqësore për fëmijët,” (2010).<sup>30</sup> Poashtu praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e njeriut është reflektuar në Udhëzuesin përkatës.

Parimet bazike që duhet marr parasysh gjatë hetimit dhe gjyqimit të punëve të rënda të fëmijëve janë:

### **Pjesëmarrja**

Duhet të respektohet e drejta e të gjithë fëmijëve për t’u informuar për të drejtat e tyre, për t’u dhënë rrugët e duhura për të pasë qasje në drejtësi dhe për t’u konsultuar e dëgjuar në proceset që përfshijnë ose i prekin ata. Kjo përfshin dhënien e të drejtës për marrjen parasysh të mendimit të fëmijëve duke pasur parasysh pjekurinë e tyre dhe çdo vështirësi komunikimi që mund të kenë, në mënyrë që ta bëjnë këtë pjesëmarrje kuptimplote.

### **Interesi më i mirë i fëmijës**

Duhet garantuar zbatimin efektiv të së drejtës së fëmijëve që interesat e tyre më të mira të jenë konsiderata kryesore në të gjitha çështjet që i përfshijnë ose i prekin ata.

Gjatë vlerësimit të interesit më të mirë të fëmijës së përfshirë ose të prekur duhet marr parasysh:

- a. opinionet dhe mendimin e tij/saj;
- b. të gjitha të drejtat e fëmijës, si e drejta për dinjitet, liri dhe trajtim të barabartë që duhen të respektohen gjatë gjithë kohës;
- c. duhet të mirret parasysh një qasje gjithëpërfshirëse nga të gjitha autoritetet përkatëse në mënyrë që të merren parasysh të gjitha interesat në rrezik, duke përfshirë mirëqenien psikologjike dhe fizike si dhe interesat ligjore, sociale dhe ekonomike të fëmijës.

- d. Poashtu, autoritetet gjyqësore që kanë përgjegjësinë për marrjen e vendimeve përfundimtare duhet të bëjnë, aty ku është e nevojshme, përpjekje të bashkërenduara për të vendosur qasje multi-disciplinare gjatë vlerësimit të interesave më të mira të fëmijës në proceset që përfshijnë fëmijën.

### **Respektimi i dinjitetit**

Fëmija duhet të trajtohet me kujdes, ndjeshmëri, drejtësi dhe respekt gjatë çdo procedure apo rasti, duke ofruar vëmendje të veçantë për situatën personale të tij/saj, mirëqenien dhe nevojat specifike, dhe me respekt të plotë për integritetin fizik dhe psikologjik. Ky trajtim duhet t’i jepet secilit fëmijë, në çdo procedurë apo çështjegjyqësore apo jo gjyqësore apo ndërhyrje të tjera, pavarësisht nga statusi dhe aftësia juridike e tij/saj.

### **Mbrojtja nga diskriminimi**

Të drejtat e fëmijës duhet të sigurohen “pa diskriminim për çfarëdo arsye si gjinia, raca, ngjyra ose përkatësia etnike, mosha, gjuha, feja, opinionet politike ose të tjera, origjina kombëtare ose sociale, prejardhja socio-ekonomike, statusi i prindërve të tyre, asociimi me pakicë kombëtare, statusi pronësor, lindja, orientimi seksual, identiteti gjinor ose statusi tjetër. Mbrojtja dhe ndihma specifike duhet t’u jepet fëmijëve më të cenueshëm, si fëmijët migrantë, fëmijët refugjatë dhe azilkërkues, fëmijët e pashoqëruar, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e pastrehë dhe të rrugës, fëmijët romë dhe fëmijët në institucione rezidenciale. Parimi i sundimit të ligjit duhet të zbatohet plotësisht tek fëmijët ashtu si për të rriturit. Poashtu elementet e procesit të rregullt, si parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, prezumimi i pafajësisë, e drejta për një gjykim të drejtë, e drejta për këshillim ligjor, e drejta për qasje në gjykim dhe e drejta për ankim, duhet të garantohen për fëmijët, sikurse për të rriturit. Duhet poashtu të sigurohen edhe mekanizmat efektiv për mbrojtjen e fëmijës si dhe ushtrimi i drejtës së ankesës në mënyrë të pavarur dhe efektive.<sup>31</sup>

<sup>30</sup> Shih në <https://rm.coe.int/16804b2cf3>

<sup>31</sup> Po aty, parimet bazë marrë nga “Udhëzuesi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës lidhur me drejtësinë miqësore për fëmijë,” 2010.

## ► KAPITULLI II

### ROLET DHE PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE NË REAGIMIN NDAJ FORMAVE TË RREZIKSHME TË PUNËVE TË FËMIJUT

## 1. Qëllimi i procedurave standarde të veprimit në hetimin dhe gjykimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve

Qëllimi i PSV është krijimi i një sistemi referues, operativ si dhe proaktiv për të reaguar me kohë në hetimin dhe gjykimin e shfrytëzimit të fëmijëve në forma të rrezikshme të punës. Për më tepër, PSV-të kanë për qëllim që poashtu të qartësojnë rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë të involvuar në mënyrë që reagimi përmes hetimeve proaktive dhe adekuate në rastet e punës së rëndë të fëmijëve, të parandalohet, referohet si dhe ofrohet drejtësi për viktimat fëmijë dhe mbrojtje e menjëhershme për fëmijën.

Me hartimin dhe zbatimin e këtyre procedurave standarde të veprimit, mekanizmat institucional shtetëror harmonizojnë dhe koordinojnë bashkëpunimin dhe bashkërendimin në fazat e aktiviteteve të hetimit, përndjekjes penale por edhe marrjes së vendimeve gjyqësore për të referuar, mbrojtë dhe riintegruar fëmijët viktimat të punëve të rënda në Kosovë. Rolet dhe përgjegjësitë si dhe procedurat e ofruara në mënyrë tabelare, duke listuar veprat penale ose të kundërvjatjes, organizatat përgjegjëse, organizatat udhëheqëse dhe ato mbështetëse janë të reflektuara drejtëpërsëdrejti nga dispozitat e legjislacionit përkatës vendor, akteve të tjera nënligjore në fuqi dhe politikave institucionale si dhe bazuar në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në përputhje me kërkesat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Këto procedura poashtu duhet të shihen në lidhshmëri me dokumentet eksistuese strategjike dhe dokumentet e tjera relevante të politikave sikurse Procedurat Standarde të Veprimit për fëmijë në forma të rrezikshme të punës, hartuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për caktimin e rolit dhe përgjegjësi të institucioneve kompetente në mbrojtjen e fëmijëve përmes identifikimit, referimit, mbrojtjes, rehabilitimit si dhe reintegrimit, të hartuara në zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve 06/L-084. Poashtu rolet dhe përgjegjësitë e Mbrojtësve të Viktimave, pjesë e Prokurorisë së Shtetit, janë specifikuar më tutje në këto PSV në mënyrë që të identifikohen më lehtë nga gjykatat,

mekanizmat ekzistues mbrojtës për fëmijët. PSV-të si dokument referues dhe operativ duhet të sigurojnë mbi gjitha mbrojtjen, përfshirë edhe reagimin në kohën dhe mënyrën e duhur për interesin më të mirë të fëmijëve, kosovarë apo të huaj apo persona pa shtetësi, për të gjitha llojet e punës dhe shfrytëzimit, të lidhur apo jo me krimin e organizuar.

Për më tepër, PSV-të kanë për qëllim të:

- Sqarojnë në detaje rolet dhe përgjegjësitë e secilit akter të involvuar në hetimin, gjykimin si dhe mbrojtjen e viktimave fëmijë nga punët e rrezikshme;
- Kërkojnë zbatimin e legjislacionit vendor dhe standardeve ndërkombëtare në përputhje me obligimet e parapara sipas Kushtetutës së Kosovës;
- Mundësojnë bashkërendimin e reagimit të menjëhershëm dhe proaktiv të prokurorëve, gjyqtarëve dhe akterëve tjerë përgjegjës me anë të mekanizmave ndër-institucional në mbrojtjen e rasteve të viktimave fëmijë nga punët e rrezikshme.

## 2. Rolet dhe përgjegjësitë e sistemit të drejtësisë dhe akterëve kyç në reagimin ndaj rasteve të fëmijëve viktimë të punëve të rënda

**Mbrojtësit e Viktimave-Prokuroria e Shtetit:** Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV) ndihmon dhe përfaqëson viktimat fëmijë në rastet e abuzimit të tyre si dhe keqtrajtimit, viktimat e dhunës në familje, trafikimit me qenie njerëzore, dhunimet, vrasjet, si dhe viktimat e krimit në përgjithësi si në polici, prokurori dhe gjykata. Rolet dhe përgjegjësitë e tyre janë përshkruar detajisht më tutje në Procedurat Standarde të Veprimit për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, aprovuar me datën 18 tetor 2014. Sipas PSV-ve të lartëcekura mbrojtësit e viktimave janë persona zyrtar të autorizuar të ofrojnë mbështetje dhe ndihmë viktimave të krimit për të pasur qasje në organet e drejtësisë, si përfaqësues i autorizuar me kompetencat e caktuara.

Dispozitat ligjore relevante	Rolet dhe përgjegjësitë
Kodi i drejtësisë për të mitur i Kosovës, Neni 3, përkufizimet	Mbrojtësit e viktimave në sistemin e drejtësisë në Kosovë janë një shembull unik, përfshirë vendet e rajonit, për të siguruar përfaqësimin ligjor të viktimave gjatë procedurës penale. Ky mekanizëm institucional është pjesë e Prokurorisë së Shtetit dhe përfaqëson interesat dhe të drejtat e viktimave të krimit, përfshirë viktimat fëmijë të abuzimit dhe keqtrajtimit para, gjatë dhe pas procedurës penale. <sup>32</sup>
Kodi i Procedurës Penale, Neni 63, alinea 3.	
Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, Neni 3, alinea 1.8.	Kodi i drejtësisë për të mitur i Kosovës përkufizon rolin dhe përgjegjësitë e mbrojtësit të viktimave si përfaqësuesi i autorizuar për mbrojtjen e interesave të fëmijëve viktimë; <sup>33</sup>
Procedurat Standarde të Veprimit për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, aprovuar me datën 18 tetor 2014	Kodi i Procedurës Penale përkufizon rolin e mbrojtësve të viktimave si përfaqësuesi i të dëmtuarit në procedurë penale;
	Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës poashtu përkufizon rolin e MV-ve duke nënkuptuar "...personin zyrtar publik, i cili përfaqëson palën e dëmtuar në procedura gjyqësore dhe administrative, përfshirë edhe fëmijën. Mbrojtësi i viktimës u ofron mbështetje dhe ndihmë viktimave të krimit, përfaqëson viktimën në procedura para gjykatës, njofton viktimën për të drejtat e tij, përfaqëson interesat e viktimës para gjykatës dhe prokurorisë, si dhe vepron në emër të viktimës kur është e nevojshme në përputhje me ligjet në fuqi." <sup>34</sup>

32 Shih Këshilli i Europës në Kosovë, publikimi "Udhëzues cilësor për strehimoret e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje," në [https://ëëë.ëave-netëork.org/ëp-content/uploads/Shelter\\_Guideline\\_ALB.pdf](https://ëëë.ëave-netëork.org/ëp-content/uploads/Shelter_Guideline_ALB.pdf)

33 Po aty, neni 3 përkufizimet, alinea 1.19. Shih në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18019>;

34 Shih Nenin 3, alinea 1.8 qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

Dispozitat ligjore relevante	Rolet dhe përgjegjësitë
	Roli i mbrojtësit të viktimave është që të sigurojë që të drejtat e viktimave të respektohen dhe të ofrohen shërbime të duhura duke përfshirë:
	<ul style="list-style-type: none"> <li>► Të njofton palën e dëmtuar për të drejtat e tij/sa;</li> <li>► Të përfaqëson interesat e viktimës në procedurë në prokurori dhe gjykatë;</li> <li>► Referon viktimën tek ofruesit e tjerë të shërbimeve;</li> <li>► Vepron në emër të viktimës kur është e nevojshme dhe e duhur për të ndaluar më tutje shkeljen e te drejtave të viktimës;</li> <li>► Zbaton dhe kërkon veprim për garantimin e mbrojtjes së viktimës;</li> <li>► Mban përgjegjësinë për të ndjekur përfaqësimin në gjykatë në emër të një viktime sipas nenit 63 të Kodit të Penale të Kosovës si dhe Kodi i Drejtësisë për të mitur;</li> <li>► Të siguron shqyrtimin e të drejtave të viktimës gjatë të gjitha fazave të procedurave të drejtësisë penale;</li> <li>► Të sigurohet që të drejtat dhe interesat e viktimave të mbrohen, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë. Kjo mund të bëhet duke u mundësuar viktimave që të dëshmojnë në gjykatë pa qenë të pranishëm ose të paktën pa praninë e autorit të dyshuar, veçanërisht përmes përdorimit të teknologjive të përshtatshme të komunikimit, aty ku është e mundur;<sup>35</sup></li> <li>► Detyrimin për të këshilluar viktimat për të drejtën e tyre për të kërkuar dëmshpërblim sipas formës së dëmit ndëshkues të paraparë në nenin 218 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;</li> <li>► Për të siguruar që viktimat të informohen për mundësinë e paraqitjes së deklaratës së dëmit të shkaktuar në mënyrë që të konsiderohet nga gjykata si palë në procedurën penale dhe që viktimat të ketë qasje në këto forma standarde. Nëse viktimat vendos të plotësojnë këtë formular, ato do ta bëjnë këtë brenda afatit kohor (nga fazat e hershme të hetimit dhe deri në 60 ditë nga ngritja e aktakuzës. Viktimat mund të ndihmohen nga përfaqësuesi i autorizuar për plotësimin e këtij formulari.</li> <li>► Të siguron bashkëpunim të duhur me strehimoret në rajonin e tyre përkatës në rastet kur viktimat edhe fëmijë kanë nevojë për strehim. Ata/ato sigurojnë që përmes strehimores edhe viktimat, të informohen paraprakisht për seancat e caktuara kur të kërkohet paraqitja e viktimës në gjykatë;</li> <li>► Të mbaj linja të hapura të komunikimit me zyrat për ndihmë juridike në rajonet e tyre për t'u siguruar që shërbimet e tilla të ofrohen për viktimat e krimeve të dhunshme;</li> </ul>

35 Këshilli i Europës në Kosovë, publikimi "Udhëzues cilësor për strehimoret e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje," në [https://ëëë.ëave-netëork.org/ëp-content/uploads/Shelter\\_Guideline\\_ALB.pdf](https://ëëë.ëave-netëork.org/ëp-content/uploads/Shelter_Guideline_ALB.pdf)

**Prokurorët:** Prokurorët, sikurse gjyqtarët, kanë përgjegjësi të sigurojnë mbrojtje për viktimat që vijnë para tyre gjatë procedurave penale. Është e rëndësishme që mbrojtja e viktimave të ndjeshme dhe fëmijëve viktimë nga punët e rrezikshme të jetë e menjëhershme, ndërsa qasja në hetimin e rasteve në fjalë të jetë proaktive. Reagimi i vonshëm mund të dëmton shëndetin dhe mirëqenien e viktimës, në mungesë të mbrojtjes së shtuar këtyre rasteve, ashtu siç kërkohet në nenet përkatëse të lartëcekura të Kodit Penal. Kosova ka një regjim gjithëpërfshirës të mbrojtjes së garantuar për viktimat e ndjeshme duke përfshirë këtu edhe fëmijët viktimë (shih pjesën e përkufizimeve të veprave penale dhe përkufizimet shtesë për kategoritë e ndjeshme më lartë në Kapitullin I).

Dispozitat ligjore relevante	Rolet dhe përgjegjësitë
Kodi i Drejtësisë për të mitur, Neni 43 përkufizimet Neni Kodi i procedurës penale, Neni 6 Shih poashtu nenin 19, alinea 1.14 mbi Dëmin	<p>Prokurori i shtetit për të mitur i cili është ekspert në çështjet penale ku është i përfshirë i mituri, fëmija dhe madhori i ri, si dhe në ndjekjen e kryerësve madhorë për veprat e kryera ndaj të miturve, është kompetent për ushtrimin e përgjegjësisë të para-para sipas Kodit të Drejtësisë për të mitur;</p> <p>Hetimet policore mund të fillohen nga zyrtari i policisë në pajtim me nenet 69-83 të Kodit të Procedurës penale.</p> <p>Procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer vepër penale.</p> <p>Vlen të ceket se prokurori i shtetit mund të fillojë procedurën penale pas marrjes së informacionit nga policia, institucioni tjetër publik, institucioni privat, qytetari, media, nga informacioni i marrë në një procedurë tjetër penale ose pas ankimit ose propozimit të të dëmtuarit.</p> <p>Nëse prokurori i shtetit vlerëson se gjatë hetuesisë janë mbledhur prova të mjaftueshme për të vazhduar shqyrtimin gjyqësor, ai/ajo harton aktakuzën dhe paraqet faktet mbi të cilat ai e bazon aktakuzën dhe siguron provat për këto fakte.</p> <p>Dëmi që drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë rezultojnë nga një veprim kriminal, si dhe shuma e dëmit mund të vërtetohet nga përfaqësuesi i të dëmtuarit, mbrojtësi i viktimave apo prokurori i shtetit. Gjykata mund të urdhërojë pagesën e dëmit bazuar në një vlerësim të arsyeshëm të vlerës monetare të dëmit të drejtpërdrejtë ose të shkaktuar në mënyrë të tërthortë si pasojë e veprës penale (Neni 19, KPP).</p> <p>Me rastin e procedurës penale, nëse gjatë procedurës vërtetohet se prindi ka keqpërdor apo i lë pas dore detyrat prindërore dhe të drejtat, ose po i shkel të drejtat e fëmijës, prokurori e informon organin e kujdestarisë për procedurën jashtëkontestimore për heqjen e të drejtave për përkujdesje prindërore nga prindi (Neni 113 KPP).</p>

**Organi i Kujdestarisë- Qendrat për Punë Sociale:** ofrojnë ndihmë viktimave në sigurimin e të drejtave, mjeteve dhe shërbimeve nga agjencitë tjera, përfshirë bashkërendimin me shërbimet e strehimit, ndihmën sociale dhe qasjen në edukim për fëmijë. QPS-ja gjithmonë thirret për reagim në rastet kur rasti ka të bëjë me fëmijë të përfshirë në rast, qoftë si viktimë të drejtpërdrejtë ose të tërthorta. Në rastet e tilla QPS-ja e siguron të gjithë ndihmën e nevojshme, me caktimin e menaxherit të rastit.

QPS-të si përfaqësues të personave në nevojë përfshirë edhe fëmijët në nevojë, ofrojnë mbështetje dhe shërbime sociale në mes tjerash për fëmijët nga marrëdhëniet e çrregulluara familjare; në rast të rrezikut nga abuzimi apo shfrytëzimi. Për më tepër, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës parasheh që QPS-të janë përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar për mbrojtjen e fëmijës në nivel komunal; të zbatojnë politikën nacionale dhe lokale për të mbrojtur fëmijën duke përfshirë edhe ndërhyrjet dhe marrjen e masave përkatëse për parandalimin si dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi si dhe dhuna.<sup>36</sup> Poashtu, secila QPS duhet të përcaktojë së paku një (1) zyrtar përgjegjës dhe të specializuar për të koordinuar masat dhe ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijës duke ushtruar çdo kompetencë sipas legjislacionit në fuqi.

Dispozitat ligjore relevante	Rolet dhe përgjegjësitë
Ligji mbi Familjen Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Nr. 02/L-17 Ligji për mbrojtjen e fëmijut Procedurat Standarde të Veprimit për monitorimin e punës së fëmijëve, hartuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Udhëzues për Menaxhimin e Rastit të Fëmijëve në Punë, MPMS	<p>Përfaqësues të personave në nevojë përfshirë edhe fëmijët në nevojë, ofrojnë mbështetje dhe shërbime sociale në mes tjerash për fëmijët nga marrëdhëniet e çrregulluara familjare; në rast të rrezikut nga abuzimi apo shfrytëzimi;</p> <p>Sigurojnë koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar për mbrojtjen e fëmijës në nivel komunal; zbatojnë politikën nacionale dhe lokale për të mbrojtur fëmijën duke përfshirë edhe ndërhyrjet dhe marrjen e masave përkatëse për parandalimin si dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi si dhe dhuna</p> <p>Ushtrojnë rolin e organit të kujdestarisë.</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>► QPS cakton menaxherin e rastit</li> <li>► Bën vlerësimin e rastit (fillestar dhe gjithëpërfshirës)</li> <li>► Koordinon aktivitetet për ofrimin e shërbimeve sociale (përgatitjen e planit të shërbimeve, zbatimin e planit të shërbimeve dhe monitorimin e rastit, përfshirë cilësinë dhe ndikimin e shërbimeve të ofruara)</li> <li>► Ofron përkrahje për viktimën</li> <li>► Për fëmijën nën moshën 18 vjet pa përkujdesje prindërore, përveç menaxherit të rastit organi i kujdestarisë e cakton edhe kujdestarin ligjor</li> <li>► Hartohet plani i punës së bashku me viktimën nëse është strehuar në strehimore për mbrojtje dhe ndihmë viktimave fëmijë;</li> <li>► Njofton viktimën për shërbimet ekzistuese dhe mundësinë e përfitimit nga ato;</li> <li>► Ndhmon në nxjerrjen e dokumenteve personale dhe shërbime tjera administrative për viktimën.</li> <li>► Në rastet kur viktimë fëmijë është në marrëdhënie të çrregulluara familjare dhe në rrezik nga keqtrajtimi apo abuzimi mund të paraqes edhe kërkesën për heqje të së drejtës prindërore para gjykatës përkatëse;</li> <li>► Ushtron rolin e organit të kujdestarisë edhe në rastet kur është hequr e drejta prindërore</li> <li>► Referon në ndihmë sociale nëse i plotëson kriteret sipas ligjit;</li> <li>► Largon fëmijën nga familja nëse ekziston rreziku;</li> <li>► Për vendime me rëndësi për fëmijët menaxheri i rastit konsultohet me kujdestarin ligjor të fëmijës;</li> <li>► Jep mendimin profesional të parashtruar me kërkesë të organeve të drejtësisë/gjykata, prokuroria, policia.<sup>37</sup></li> </ul>	

<sup>36</sup> Neni 15, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijut.

<sup>37</sup> Adaptuar nga përgjegjësi ligjore të QPS-ve përkufizuar në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, si dhe PSV-të për trajtimin dhe ofrimin e ndihmës viktimave të dhunës në familje. Shif në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2447>

**Organizatat mbështetëse- Strehimoret:** Ofrojnë strehim afatshkurtër dhe afatmesem si dhe shërbime tjera mbështetëse për viktimat dhe familjet e tyre pas viktimizimit.<sup>38</sup> Në rastet e abuzimeve dhe keqtrajtimit më serioz mund të ofrojnë edhe strehim rezidencial deri sa viktimat fëmijë mbush moshën madhore.<sup>39</sup> Sipas Nenit 8 të Ligjit 02/L-17 të Kosovës për Shërbime Sociale dhe Familjare,<sup>40</sup> sektori joqeveritar ofron shërbime me kontratë, në emër të Drejtorisë komunale në rast të shërbimeve lokale, si dhe Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare me mbështetje të tani Ministrisë së Punës, Transfereve dhe Financave (menaxhuar në të kaluarën nga ish-MPMS), kur lind nevoja për të ofruar shërbime në mbarë Kosovën ose edhe me iniciativën e tyre (për shembull me mbështetjen e donatorëve). Prandaj, sektori joqeveritar që ofron shërbime për viktimat e krimit përfshirë këtu viktimat e dhunës në familje, abuzimit dhe keqpërdorimit të fëmijëve por edhe viktimave të trafikimit kryesisht, është regjistruar pranë MPMS-së dhe i është nënshtruar licencimit duke u dakorduar që t'i përmbahen rregulloret të licencimit siç përcaktohen nga ministria.<sup>41</sup> Gjithashtu, ministria ka ofruar mbështetje financiare për strehimoret që nga viti 2005 dhe strehimoret kanë të drejtë të kërkojnë mbështetje për financim nga komunat. Çdo vit, Ministria e Financave, Transfereve dhe Punës duhet përmes thirrjes publike të shpall për kontraktim të jashtëm shërbimet sociale dhe financimin e OJQ-ve, sipas Rregullores së Qeverisë së Kosovës (Ministria e Financave) Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat për Financimin Publik të OJQ-ve.

Tani për tani në Kosovë ekzistojnë 41 OJQ të licencuara nga të cilat dhjetë OJQ janë licencuar dhe kontraktuar si ofrues të shërbimeve për strehimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe viktimave të trafikimit si dhe viktimave fëmijë. Deri në dhjetor 2019, kishte 900 individë të licencuar për të ofruar shërbime sociale dhe 21 OJQ të licencuara. Ekzistojnë 22 politika të standardeve minimale të miratuara nga MPMS-ja për sigurimin e shërbimeve sociale (Shif, Strategjia e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, 2018-2022 si dhe raporti Këshilli i Evropës, 2019).<sup>42</sup> Strehimoret gjithashtu ofrojnë shërbime dhe trajnime profesionale për viktimat me qëllim të riintegrit të tyre në shoqëri.

38 Shih për shembull "Procedurat Standarde të Veprimit për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, në <https://docplayer.net/69548956-Udhëzime-mbi-procedurat-standarde-te-veprimit-per-zyren-per-mbrojtje-dhe-ndihme-viktimave.html>

39 Shih Këshilli i Europës në Kosovë, publikimi "Udhëzues cilësie për strehimoret e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje," në [https://ëëë.ëave-netëork.org/ëp-content/uploads/Shelter\\_Guideline\\_ALB.pdf](https://ëëë.ëave-netëork.org/ëp-content/uploads/Shelter_Guideline_ALB.pdf)

40 Shih në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2447>

41 Shih Këshilli i Europës në Kosovë, publikimi "Udhëzues cilësie për strehimoret e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje," në [https://ëëë.ëave-netëork.org/ëp-content/uploads/Shelter\\_Guideline\\_ALB.pdf](https://ëëë.ëave-netëork.org/ëp-content/uploads/Shelter_Guideline_ALB.pdf)

42 Shih raportin Këshilli i Europës në Kosovë "Vlerësimi i Nevojave për zhvillimin e Udhëzuesit të Cilësisë për Strehimoret e DhNG dhe DhF në Kosovë (2019).

Dispozitat ligjore relevante	Rolet dhe përgjegjësitë
Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Nr. 02/L-17  Ligji për mbrojtjen e fëmijut  Rregullorja e Qeverisë së Kosovës (Ministria e Financave) Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat për Financimin Publik të OJQ-ve	Ofrojnë strehim afatshkurtër dhe afatmesem si dhe shërbime tjera mbështetëse për viktimat dhe familjet e tyre pas viktimizimit;  Në rastet e abuzimeve dhe keqtrajtimit më serioz mund të ofrojnë edhe strehim rezidencial deri sa viktimat fëmijë mbush moshën madhore;  Ofrojnë shërbime me kontratë, në emër të Drejtorisë komunale në rast të shërbimeve lokale, si dhe Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare me mbështetje të tani Ministrisë së Punës, Transfereve dhe Financave (ish-MPMS), kur lind nevoja për të ofruar shërbime në mbarë Kosovën ose edhe me iniciativën e tyre me perkrahjen e donatoreve.
	<ul style="list-style-type: none"> <li>► Strehimoret ofrojnë ambient të sigurt dhe perkrahës;</li> <li>► Veshmbathje, ushqim;</li> <li>► Shërbime mjekësore dhe medikamente;</li> <li>► Këshillim psikosocial dhe këshillim ligjor;</li> <li>► Aktivitete rekreative;</li> <li>► 24 orë siguri dhe kujdes;</li> <li>► Kontaktojnë MV-të për këshillim ligjor për viktimën;</li> <li>► Mund të referojnë viktimën për trajtim mjekësor;</li> <li>► Zhvillojnë planin individual për viktimën në bashkëpunim me QPS-në;</li> <li>► Kërkojnë prezencën e Menaxherit të Rastit nga QPS për çështje administrative –nxjerrjen e dokumenteve;</li> <li>► Ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të viktimës;</li> <li>► Mundësimi i kontaktit të monitoruar të viktimës me familjar si dhe njoftimi i familjës në rastet kur nuk është hequr e drejta prindërore;</li> <li>► Këshillimi i viktimes për pasojat potenciale në rast se refuzon strehimin;</li> <li>► Hapja e dosjes së rastit;</li> <li>► Informimi i viktimes për rregullat dhe shërbimet e strehimores si dhe hartimi i planit individual</li> <li>► Zhvillimi i Marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet strehimores, QPS dhe viktimës për planin e edukimit;</li> <li>► Ofrimi i trajnimeve;</li> <li>► Duhet të sigurojnë hapësirë të veçantë për viktimat me nevoja të veçanta</li> </ul>



## 3. Palët e tjera në përkrahje të viktimave fëmijë

### **Institucionet arsimore**

Institucionet Arsimore planifikojnë mbështetjen e individualizuar edukative për tërheqjen e fëmijëve nga puna si dhe identifikojnë barrierat e qasjes në arsim në nivel shkolle. Poashtu mund të planifikojnë intervenimet në nivel shkolle dhe propozojnë masat për Departamentin Komunal të Arsimit si dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.<sup>43</sup>

Institucionet arsimore mund të planifikojnë aktivitete sensibilizuese për nxënësit për problemin e lidhur me punët e rrezikshme si dhe planifikojnë bashkëpunimet me ofruesit tjerë të shërbimeve dhe partnerët sikurse policinë, QPS-të, OJQ-të që ofrojnë programe edukative dhe që kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve, bizneset, etj. Qëllimi duhet të jetë largimi nga puna i fëmijëve që kombinojnë shkollën dhe punën apo/dhe kthimin e reintegrimit të fëmijëve të cilët e kanë braktisur shkollën.<sup>44</sup>

### **Institucionet shëndetësore**

Institucionet shëndetësore kryejnë identifikimin e viktimave në kontaktet e para me ta gjatë kontrollit mjekësor; ofrojnë shërbime shëndetësore për viktimën si dhe shërbime pa pagesë. Ato duhet të njoftojnë policinë në rastet kur dyshohet se plaget apo lëndimet e pacientit janë shkaktuar si rezultat i dhunës apo keqtrajtimit dhe abuzimit të fëmijut. Poashtu duhet të përgatisin raportin mjekësor si dhe hapin dosjen e rastit që mbahet konfidencial në bazë të ligjit për ruajtjen e të dhënave personale.<sup>45</sup> Poashtu përgadisin raportin me shkrim lidhur me rastin kur kërkohet nga organet e drejtesise si dhe zbatojnë kërkesen për trajtimin e obligueshëm mjekësor për varesin nga droga dhe alkooli dhe trajtimin psikosocial duke përfshirë edhe rastet e kryesve të dhunës sipas masës së shqiptuar nga gjykata. Poashtu institucionet shëndetësore, planifikojnë aktivitete këshilluese për prindërit ose kujdestarët dhe anëtarët tjerë të familjes së fëmijëve të lënduar në punë për rreziqet e mundshme në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve. Planifikojnë bashkëpunimet me institucionet shkollore dhe QPS-të në ofrimin e mbështetjes profesionale në trajtimin e temës së abuzimit ekonomik të fëmijëve dhe pasojat për shëndetin (PSV-te, MFPT).

**Qendrat e aftësisë profesionale**, gjenden brenda qendrave rajonale të punësimit të cilat ofrojnë një sërë trajnimesh profesionale për viktimat. Pas përfundimit të trajnimit, viktimat mund të regjistrohen në listën e punëkërkuësve në mënyrë që të merret në konsideratë për punësim.

<sup>43</sup> Procedurat Standarde të Veprimit për Fëmijë në Forma të Rrezikshme të Punës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2021.

<sup>44</sup> Po aty.

<sup>45</sup> Po aty.

## ► KAPITULLI III

### MBROJTJA E VIKTIMAVE FËMIJË NGA PUNËT E RREZIKSHME

Prokurorët dhe gjyqtarët pritët të ofrojnë informacionet në lidhje me të drejtat e viktimës të cilat përfshijnë:

- Viktimat kanë të drejta të caktuara dhe duhet të informohen për ato të drejta.
- Viktimat duhet të informohen mirë në mënyrë që të marrin vendimet e tyre për pjesëmarrjen në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale. Nuk rekomandohet thjesht të lexoni një listë të të drejtave të viktimave. Është më efektive të zhvillohet një bisedë me viktimën në lidhje me proceset përkatëse kriminale, detyrimet dhe të drejtat e tij/saj, të cilat do ta lejonin atë të bënte pyetje. Biseda të tilla duhet të zhvillohen sa më herët që të jetë e mundur. Praktikë e mirë është t'i shpjegoni viktimës personalisht të drejtat e tij/saj dhe t'i siguroni material me shkrim që viktima mund të konsultohet më vonë.
- E drejta për t'u trajtuar me ndjeshmëri dhe respekt për dinjitetin e tyre.
- E drejta për të pasur qasje në sistemin e drejtësisë penale dhe trajtim të shpejtë.
- E drejta për kthim dhe kompensim të drejtë, duke përfshirë bërjen e një kërkesë për kompensim të dëmit në lëndët penale.
- E drejta për të shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre dhe për t'i paraqitur dhe shqyrtuar ato në fazat e duhura të lëndës penale, duke përfshirë: paraqitjen e propozimeve në lidhje me provat; rishikimin e shënimeve dhe njohjen e tyre dhe bërjen e propozimeve për hetime të mëtejshme; dhe të dëgjohet në seancat paraprake, seancën kryesore dhe mbajtjen e një fjalimi përfundimtar.
- E drejta për të pasur ndihmën e duhur gjatë gjithë procesit ligjor, përfshirë ndihmën juridike
- E drejta për informim në lidhje me të drejtat e tyre, rolin dhe qëllimin e tyre, kohën dhe mbarëvajtjen e lëndës së tyre dhe zgjidhjen e lëndës së tyre, përfshirë informacionet në lidhje me lirimimin e personit të akuzuar/dënuar nga paraburgimi ose arratisjen nga paraburgimi; statusin e ankesës së tyre, ecurinë e hetimeve ose procedurave, rolin e tyre në procedurë dhe rezultatin e lëndës.

- E drejta për mbështetje, përfshirë ndihmën e nevojshme materiale, mjekësore, psikologjike dhe sociale përmes mjeteve qeveritare, vullnetare, të bazuara në komunitet dhe të brendshme.<sup>46</sup>

#### 1. Këshilla komunikimi për prokurorët kur intervistohen viktimat fëmijë

- Duhet pasur kujdes kur intervistohen viktimat në një qasje me viktimën në qendër në mënyrë që të mos shkaktohet viktimizim dytësor, si dhe për të siguruar që autori i krimit të mbahet përgjegjës.
- Komunikimi efektiv me viktimën në fillim është thelbësor për të ndihmuar viktimën për të dhënë një tregim të qartë të asaj që ka ndodhur. Kjo do t'u mundësojë prokurorëve që të marrin vendime më të informuara se si të procedojnë me rastin.
- Prokurori duhet të krijojë besim tek viktima. Viktima duhet të dijë se ai/ajo po dëgjohet dhe se nevojat e tyre po kuptohen dhe adresohen.
- Informacioni dhe mënyra e komunikimit të prokurorit mund ta fuqizojnë atë për mbarëvajtjen e procesit gjyqësor. Intervista duhet të zhvillohet në një mjedis neutral, ku viktima ndihet e sigurt dhe rehat dhe duhet të ketë privatësinë. Vendndodhjet e intervistës nuk duhet të jenë në dhomën e marrjes në pyetje në stacionin policor ose ku viktima mund të vihet në kontakt me autorin e veprës. Prokurori dhe një mbrojtës i viktimave nëse është e mundur duhet të zhvillojnë intervistën së bashku. Avokati i viktimës do të sigurojë mbështetje ndërsa kalon traumën e rrëfimit të shkeljes. Konsideroni lejimin e viktimës që të shoqërohet në takime nga një avokat dhe/ose person mbështetës. Kur lejoni një person mbështetës që është i afërm ose mik, merrni parasysh nëse prania e një personi të tillë mund të konsiderohet e dëmshme. Merrni parasysh të bëni regjistrime të intervistës me viktimën (audio dhe vizuale nëse është e mundur), për të zvogëluar nevojën për intervista shtesë.
- Gjatë bashkëveprimit me viktimën është e rëndësishme që ju ta vini viktimën në

<sup>46</sup> Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/34

qetësi duke përdorur një gjuhë të sigurt dhe mbështetëse. Dëgjoni viktimën me kujdes. I jepni asaj kohë të tregojë se çfarë ka ndodhur. I jepni kohë viktimës të tregojë se çfarë ka ndodhur me fjalët e tij/saj (d.m.th. intervistë e pastrukturuar). Pastaj kur ka gjëra të mbetura nga ato që keni dashur të eksploroni, gjithmonë mund t'u ktheheni atyre me pyetje të hapura.

- Kur bëni pyetje, mundësoni qetësinë në bisedë që viktimë të qartësojë mendimet
- Bëni pyetje qartë dhe në mënyrë jo-gjyquese ose akuzuese.
- Mos përdorni gjuhë teknike juridike. Ndërsa është e rëndësishme të tregoni ndjeshmëri gjatë intervistës, mos u bëni tepër emocionues. Ju duhet të siguroni që viktimë ka kontroll mbi rrjedhën e informacionit dhe të shmangni rrezikun e imponimit të pikëpamjeve tuaja personale
- Mos shprehni zhgënjim ose bezdi nëse viktimë ka vështirësi të kujtojë fakte ose të japë përgjigje të qarta. U kushtoni vëmendje shenjave të traumës, ankthit ose stresit dhe ofroni siguri kur është e nevojshme.
- Mos bëni premtime që nuk mund t'i mbani.
- Ndjekja penale e një rasti mund të zgjasë shumë dhe kjo mund të jetë e vështirë për viktimën. Përpiquni të kuptoni sfidat e viktimës. Viktimat mund të kenë probleme të shumta, pasi viktimat fëmijë janë të ndjeshme. Mund të kenë vetëvlerësim të ulët ose mund të përjetojnë sërish të kaluarën duke përjetuar ankth ose agresion.
- Jini të durueshëm dhe kaloni kohë me ta;
- Në përfundim të intervistës, sigurohuni që viktimë është e vetëdijshme për mundësinë e komunikimit me ju dhe mundësinë e kontaktit. Shpjegoni rolin e viktimës në procesin gjyqësor, duke përfshirë fazat e gjyqimit penal, kohën, dhe nëse do të përdoret ndonjë procedurë e veçantë (p.sh. dëshmia me video, mbrojtjet). Viktimë ka shumë gjasa të mos ketë njohuri për sistemin ligjor.
- Bëjini të ditur se mund të ketë një periudhë të konsiderueshme kohe ndërmjet intervistës aktuale dhe paraqitjes në gjyq. Shpjegoni se si

do të përdoret deklarata e tij/saj në procesin gjyqësor dhe se mbrojtja do të marrë një kopje të saj.

- Shpjegoni rolin e juaj në procedurës penale, duke përfshirë rolin e aktorëve të tjerë të sallës së gjyqit, të tillë si gjyqtari, nëpunësi i gjykatës, etj. Shpjegoni të drejtat dhe mundësitë e viktimës.<sup>47</sup>

## 2. Këshilla komunikimi për gjyqtarët kur bashkëveprojnë me viktimën

Ndërveprimet e gjyqtarëve me viktimat zakonisht janë të kufizuara në dëshminë e dëshmitarëve në gjykatë (gjatë seancave në procedurë paraprake ose në gjykim). Të gjithë gjyqtarët duhet të kenë parasysh se viktimë/dëshmitari mund të ketë pasur ndërveprime më herët në gjykatë dhe kështu duhet të jenë të përgatitur për të shpjeguar qartë procesin ligjor që po ndodh në moment, rezultatet e mundshme dhe pasojat për viktimën. Të gjithë gjyqtarët luajnë rol kritik në minimizimin e faktorëve që kontribuojnë në viktimizimin sekondar dhe ri-traumatizim. Kjo mund të bëhet duke përfshirë një qasje të ndjeshme ndaj viktimës në angazhimin/ ndërveprimet e tyre me viktimat.<sup>48</sup>

## 3. Tregues për gjyqtarët kur komunikojnë me viktimat:

- Dëgjoni viktimën me kujdes.
- Jeni proaktivë kur pyetni për detaje specifike.
- Mos bëni pyetje padrejtësisht ndërhyrëse, pyetje të turpshme ose të përsëritura haptazi.
- Trajtoni viktimat me dinjitet dhe respekt. Është gjyqtari ai që vendos tonin dhe krijon mjedisin për një gjykim të drejtë në gjykim.
- Mos shprehni zhgënjim ose bezdi nëse viktimë duket se nuk është bashkëpunuese.
- Mbani në mend si ato që thoni ashtu edhe ato që komunikoni përmes gjuhës së trupit.
- Shpjegoni të drejtat dhe mundësitë e viktimës.
- Shpjegoni qëllimin e seancës së veçantë dhe procesin.

47 Shih po aty si dhe Manuali për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Trajtimin e Rasteve të Dhunës në Familje, Pjesa mbi Standardet Ndërkombëtare, Këshilli I Europës, 2021.

48 Po aty.

# 2. Të drejtat e përkufizuara në legjislacion lidhur me mbrojtjen e fëmijëve viktimë

Kodi i drejtësisë për të mitur poashtu shpjegon në detaje procesin e mbrojtjes së fëmijëve viktimë duke reflektuar një sërë të drejtave të garantuara nga standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijut në veçanti.

### E drejta për t'u informuar (Neni 119):<sup>49</sup>

Fëmija viktimë apo dëshmitar, prindërit, prindi adoptues, kujdestari, përfaqësuesi i autorizuar, mbrojtësi i viktimave, që nga kontakti i tyre i parë me procesin gjyqësor dhe gjatë gjithë këtij procesi, informohen menjëherë për rrjedhën e procesit dhe, për aq sa është e mundur dhe e përshtatshme, lidhur me:

- Procedurat gjyqësore penale ku përfshihen të rritur dhe të miturit, përfshirë rolin e fëmijëve viktimë apo dëshmitarë, rëndësia, koha dhe mënyra e dhënies së dëshmisë, si dhe mënyrat si do të kryhen intervistat gjatë procedurës përgaditore apo gjyqimit;
- Mekanizmat ekzistues mbështetës për fëmijën viktimë apo dëshmitar kur bën ankesë dhe merr pjesë në procedurën përgaditore apo procedurën gjyqësore, përfshirë vënien e një përfaqësuesi të autorizuar ose personi tjetër të përshtatshëm, të caktuar për të ofruar asistencë, në dispozicion të viktimës;
- Vendi dhe orari i veçantë i seancave dhe veprimtarive të tjera përkatëse;
- Disponueshmërinë e masave mbrojtëse;
- Mekanizmat ekzistues për shqyrtimin e vendimeve që dëmtojnë fëmijën viktimë apo dëshmitar;
- Të drejtat përkatëse të fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë;
- Mundësitë ekzistuese për përfundimin e dëmshpërblimit nga kryesi i veprës penale ose nga shteti përmes procesit gjyqësor, procedurës civile apo proceseve të tjera;

► Disponueshmërinë e shërbimeve shëndetësore, psikologjike, sociale dhe shërbimeve të tjera përkatëse dhe të mjeteve që mundësojnë përdorimin e këtyre shërbimeve, si dhe disponueshmërinë e këshillave apo përfaqësimit ligjor ose të ndonjë lloji tjetër dhe mbështetjes emergjente financiare, nëse është e mundur një gjë e tillë;

► Informimin lidhur me progresin dhe zgjidhjen e çështjes specifike, përfshirë ndalimin, arrestimin dhe mbajtjen në gjendje paraburgimi të të akuzuarit, ndonjë ndryshim të afërt të kësaj gjendjeje, vendimin e prokurorit, zhvillimet përkatëse pas përfundimit të gjyqimit dhe rezultatit përfundimtar të çështjes.

**Siguria e fëmijës viktimë:** Në çdo fazë të procesit gjyqësor, kur siguria e fëmijës viktimë apo dëshmitar gjykohet se është në rrezik, gjyqtari kompetent vendos për marrjen e masave mbrojtëse për fëmijën. Këto masa mund të përfshijnë masat e parapara në Ligjin përkatës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, *por duke mos u kufizuar* si më poshtë: 1.1. të shmangët kontakti i drejtpërdrejtë mes fëmijës viktimë ose dëshmitar dhe të akuzuarit, në çdo etapë të procesit gjyqësor; 1.2. të kërkohet mbrojtje për fëmijën viktimë apo dëshmitar nga policia ose institucionet të tjera përkatëse dhe të mos bëhet publike vendndodhja e fëmijës; 1.3. të merren ose të kërkohet nga autoritetet kompetente marrja e masave të tjera mbrojtëse që mund të gjykohen të përshtatshme.<sup>50</sup>

Gjyqtari kompetent siguron që procedurat lidhur me dëshminë e fëmijës viktimë apo dëshmitar, të zhvillohen në një gjuhë që të jetë e thjeshtë dhe e kuptueshme për fëmijën. Nëse fëmija ka nevojë për ndihmë e përkthimit në një gjuhë që fëmija e kupton, atij i vihet në dispozicion një përkthyes falas. Nëse, duke patur parasysh moshën, nivelin e pjekurisë ose nevojat e veçanta individuale të fëmijës, që mund të përfshijnë, por jo vetëm, aftësitë e kufizuara, nëse ka, varfërinë apo

49 Shih Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/18 tetor 2018, Prishtinë 54 Kodi Nr. 06/I-006 i Drejtësisë për të Mitur.

50 Neni 121 Masat dhe urdhërat mbrojtëse 1.

rrezikun e riviktimizimit, vlerësohet se a duhen marrë masa për ndihmë të veçantë, me qëllim që fëmija të dëshmojë ose të marrë pjesë në procesin gjyqësor, këto masa sigurohen falas.<sup>51</sup>

Që nga fillimi i fazës hetimore dhe gjatë gjithë procesit gjyqësor, fëmijët viktimë apo dëshmitarë mbështeten nga një person që është trajnuar dhe ka aftësi profesionale për të komunikuar me fëmijët e moshave dhe formimeve të ndryshme dhe për t'u ardhur në ndihmë atyre me qëllim parandalimin e rrezikut të ushtrimit të dhunës, riviktimizimit. Personi mbështetës caktohet nga gjyqtari kompetent. Personit mbështetës i jepet kohë e mjaftueshme për t'u njohur me fëmijën përpara se të bëhet intervista e parë. Çdo intervistë e fëmijës viktimë apo dëshmitar, që kryhet në kuadrin e procesit gjyqësor, bëhet në prani të personit mbështetës. Vazhdimësia e marrëdhënieve mes fëmijës dhe personit mbështetës sigurohet për aq sa është e mundur, gjatë gjithë procesit gjyqësor. Gjyqtari kompetent, që caktoi personin mbështetës, monitoron punën e personit mbështetës dhe e ndihmon atë, sipas rastit. Nëse personi mbështetës nuk i kryen detyrat dhe funksionet e tij në përputhje me këtë kapitull, gjykata cakton një person mbështetës zëvendësues pas këshillimit me fëmijën.<sup>52</sup>

**Roli i personit mbështetës:** Ofron fëmijës mbështetje të përgjegjshme emocionale; ofron fëmijës asistencë, në një mënyrë të përshtatshme për fëmijën, gjatë gjithë procesit gjyqësor. Kjo asistencë mund të përfshijë masat për zbutjen e pasojave negative të veprës penale të fëmija, masat për t'i ardhur në ndihmë fëmijës që të vazhdojë jetën e tij të përditshme, si dhe masat për t'i ardhur në ndihmë fëmijës që të përballojë çështjet administrative, që lindin nga rrethanat e çështjes; jep këshilla nëse terapia apo këshillimi është i nevojshëm; lidhet dhe komunikon me prindërit ose kujdestarin, familjen, miqtë dhe përfaqësuesin e autorizuar, sipas rastit; e informon fëmijën për përbërjen e ekipit hetimor apo të gjykatës, si dhe për të gjitha çështjet e tjera që parashikohen në këtë kapitull; Duke koordinuar me përfaqësuesin e autorizuar që përfaqëson fëmijën ose në mungesë të këtij përfaqësuesi i autorizuar, diskuton me gjykatën, fëmijën dhe prindërit ose kujdestarin e tij lidhur me alternativat e ndryshme

për dhënien e dëshmisë, si, për shembull, kur vihen në dispozicion, regjistrimi me video dhe mjete të tjera për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës.

Duke koordinuar me avokatin që përfaqëson fëmijën ose në mungesë të këtij avokati, diskuton me policinë, prokurorin dhe gjykatën nëse është e këshillueshme që të lëshohet urdhër për masat mbrojtëse; Kërkon lëshimin e urdhrit për masat mbrojtëse, sipas rastit.<sup>53</sup>

**Ambientet e pritjes:** Gjykata siguron që fëmijët viktimë apo dëshmitarë të kenë mundësi të presin në ambiente të posaçme pritjeje, të mobiluara në një mënyrë të përshtatshme dhe miqësore për fëmijët, përfshirë lehtësirat për personat me nevoja të veçanta. Kur është e mundur, ambientet e pritjes që përdoren nga fëmijët viktimë apo dëshmitarë, duhet të jenë të ndara nga ambienti i pritjes të caktuar për dëshmitarët në moshë madhore. Gjyqtari kompetent, sipas rastit, mund të urdhërojë që fëmija viktimë apo dëshmitar, të presë në një vend larg sallës së gjyqit dhe ta ftojë fëmijën për t'u paraqitur kur është e nevojshme. Gjyqtari kompetent i jep përparësi dëgjimit të dëshmisë së fëmijëve viktimë apo dëshmitarë, me qëllim shkurtimin e kohës së pritjes gjatë paraqitjes në gjykatë.

**Mbështetja emocionale për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë (Neni 128):** Përveç prindërve, kujdestarit dhe përfaqësuesit të autorizuar ose personit tjetër të përshtatshëm, që caktohet për të ofruar asistencë sipas rastit, gjyqtari kompetent lejon që personi mbështetës ta shoqërojë fëmijën viktimë apo dëshmitar gjatë gjithë kohës që ai merr pjesë në procedurat gjyqësore, me qëllim reduktimin e ankthit apo stresit. Gjyqtari kompetent informon personin mbështetës se ai, si dhe vetë fëmija, mund t'i kërkojnë gjykatës pushim kur fëmija ka nevojë për të. Gjyqtari kompetent mund të urdhërojë largimin e prindërve ose kujdestarit të fëmijës nga seanca vetëm kur kjo gjë është në interesin më të lartë të fëmijës.

**Pajisjet në sallën e gjyqit (Neni 129):** Gjyqtari kompetent siguron që në sallën e gjyqit të bëhen rregullimet e përshtatshme për fëmijët viktimë apo dëshmitarë, si, për shembull, por pa u kufizuar vetëm në to, përdorimi i karrigeve me ndenjësë të ngritura dhe asistencë ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara. Plani i sallës së gjyqit siguron se, për aq sa është e mundur, fëmija të ketë mundësi të ulët pranë prindërve apo kujdestarit, personit mbështetës ose përfaqësuesi i autorizuar i tij, gjatë gjithë procedurave.

**Pyetja nga pala kundërshtare (Neni 130):** Sipas rastit dhe duke marrë në konsideratë të drejtat e kryesit, gjyqtari kompetent nuk lejon pyetjen e fëmijës viktimë apo dëshmitar nga kryesi. Kjo pyetje nga pala kundërshtare mund të ndërmerret nga përfaqësuesi i autorizuar përmes gjyqarit për të mitur, i cili ka detyrën të parandalojë drejtimin e ndonjë pyetjeje që mund ta ekspozojë fëmijën ndaj kanosjes, vështirësisë apo ankthit të panevojshëm. Gjyqtari mund të ndërmarrë masa për të mbrojtur viktimën fëmijë me anë të intervistës nëse është e mundur prapa një xhami të patejdukshëm; duke përdorur pajisje që ndryshojnë figurën ose zërin; përmes pyetjes në një vend tjetër, që transmetohet njëkohësisht në sallën e gjyqit, me anë të monitorit me qark të mbyllur; me anë të pyetjes së regjistruar në videokasetë të fëmijës dëshmitar, përpara seancës dëgjimore, në rastet kur përfaqësuesi i autorizuar i kryesit merr pjesë në pyetje dhe atij i jepet mundësia që ta pyesë fëmijën viktimë apo dëshmitar; të mbahen seanca të mbyllura; si dhe të urdhëron largimin e përkohshëm të kryesit nga salla e gjyqit nëse fëmija nuk pranon të japë dëshmi në prani të të akuzuarit, apo nëse rrethanat tregojnë se fëmija mund të frenohet që të thotë të vërtetën në prani të atij personi. Poashtu lejohen pushime gjatë kohës që fëmija jep dëshmi; si dhe të merret çdo masë tjetër që gjykata mund ta vlerësojë të nevojshme, përfshirë, sipas rastit, ruajtjen e fshehtësisë dhe marrjen në konsideratë të interesit më të lartë të fëmijës dhe të të drejtave të të akuzuarit.

**Informacioni për rezultatin përfundimtar të gjyqit (Neni 133 dhe Neni 134):** Gjyqtari kompetent e informon fëmijën, prindërit ose kujdestarin ligjor dhe personin mbështetës për rezultatin përfundimtar të gjyqit. Gjyqtari kompetent e fton personin mbështetës që t'i ofrojë mbështetje emocionale fëmijës, që ta ndihmojë atë ta pranojë rezultatin përfundimtar të gjyqit, nëse është e nevojshme. Menjëherë pas përfundimit të procedurave gjyqësore, personi mbështetës lidhet me organizatat ose profesionistët e përshtatshëm, për të siguruar që fëmijës viktimë apo dëshmitar t'i ofrohet këshillim ose trajtim i mëtejshëm, nëse është e nevojshme.

51 Neni 122 Gjuha, përkthyesi dhe masa të tjera për ndihmë të veçantë.

52 Neni 124, KDM.

53 Neni 125 i Kodit Drejtësisë për të Mitur.



## SHTOJCAT:

---

Shtojca 1: TABELA E PSV-VE PËR REAGIMIN NË RASTET  
E RREZIKSHME TË PUNËS SË FËMIJËVE

Shtojca 2: MEKANIZMAT DHE KO-ORDINIMI NDËRINSTITUCIONAL



## ► SHTOJCA 1:

### Tabela e PSV-ve për reagimin në rastet e rrezikshme të punës së fëmijëve

#### HETIMI

Veprimet	Institucioni bartës	Institucioni Mbështetës	Veprimet mbështetëse nga akterët tjerë
1. Pas marrjes së informatës prej akterëve të ndryshëm (Policia, Media, Personat privat, etj) fillon procesi hetimor	Policia, Prokurori Shtetit	Mbrojtësit e Viktimës Qendra për Punë Sociale	Media, Persona Privat, Institucionet Arsimore, Institucionet Shëndetësore, OJQ-të, etj.
2. Autorizohet policia për të ndërmarr veprime hetimore të caktuara sikurse grumbullimi i provave, koha e kryerjes së veprës penale, mënyra e kryerjes së veprës penale)	Prokurori Shtetit, Policia e Kosovës	Mbrojtësit e Viktimës Qendra për Punë Sociale	Institucionet Shëndetësore Institucionet Arsimore, Forenzika
3. Mbledhja e provave si process nënkupton në mes tjerash: marrjen e deklaratës së fëmiut si viktimë (jo më shumë se 2 herë sipas procedurës penale); marrja e dëshmimeve nga dëshmitarët tjerë; deklarata e personit të dyshuar; informatat nga Qendra për Punë Sociale dhe mbrojtësi i viktimave; raportet mjekësore; mbledhja e provave materiale; kqyrja e vendit të ngjarjes; fotografimi; dokumentacioni përcjellës për rastin si dhe marrja e shënimit zyrtar nga QPS-ja, etj Poashtu sigurohet edhe prania e psikologut, mbrojtësit të viktimave, QPS-së, prindit kur është e mundur (jo në rastet kur kërkohet heqja e drejtës prindërore)	Prokurori Shtetit, Policia e Kosovës	Mbrojtësit e Viktimës Qendra për Punë Sociale	Institucionet Shëndetësore Institucionet Arsimore Forenzika
4. Pas provave të mbledhura bëhet fillimi i hetimeve ose kallëzimi penal	Prokurori Shtetit, Policia e Kosovës	Mbrojtësit e Viktimës Qendra për Punë Sociale	Institucionet arsimore dhe shëndetësore
5. Ngritja e aktakuzës	Prokurori Shtetit	Mbrojtësit e Viktimës Qendra për Punë Sociale, Policia e Kosovës	
6. Veprimet procedurale të gjykatës (caktohet kompetenca, afati i parashkrimit, shqyrtimi fillestar, shqyrtimi i dytë dhe shqyrtimi kryesor)	Gjyqtari kompetent	Palët e involvuara në procedurë gjyqësore	
7. Nëse gjatë procedurës penale vërtetohet se prindi i keqpërdor apo i lë pas dore detyrat prindërore dhe të drejtat, ose po i shkel të drejtat e fëmijës, prokurori e informon organin e kujdestarisë për procedurën jashtëkontestimore për heqjen e të drejtave për përkujdesje prindërore nga prindi.	Prokurori Shtetit	MV-ja, QPS-ja	Organizatave e licencuara në ofrimin e shërbimit të strehimit për fëmijë pa përkujdesje prindërore

8. Viktima informohet për të drejtat e saj/tij në gjykatë (prokurori, MV-ja, gjyqtari kompetent) dhe krijohet një ambient i përshtatshëm gjatë marrjes në pyetje të viktimës fëmijë në përputhje me teknikat dhe procedurat e marrjes në pyetje të përkufizuara në Kapitullin I, Pjesa pestë e Kodit të Drejtësisë për të mitur	Prokurori Shtetit Mbrojtësi Viktimave	Qendra për Punë Sociale si institucion mbështetës përkufizuar edhe në Kodin për Drejtësi për të mitur	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijët viktimë të abuzimit dhe keqtrajtimit mund të ofrojnë edhe këshillime psiko-sociale si dhe strehim të përkohshëm
9. Në përputhje me kërkesat e Kodit të Drejtësisë për të mitur, shërbimet, institucionet ose organizatat që ofrojnë shërbimet për fëmijë, marrin masat e përshtatshme me qëllim që personat, të cilët janë akuzuar për një veprë penale, të cilësuar si veprë penale ndaj një fëmije, nuk janë në kontakt me fëmijët (Neni 116)	Prokurori Shtetit Gjyqtari Kompetent	Qendra për Punë Sociale Mbrojtësi i Viktimave	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijët viktimë të abuzimit dhe keqtrajtimit mund të ofrojnë edhe këshillime psiko-sociale si dhe strehim të përkohshëm
10. Fëmija viktimë apo dëshmitar që nga kontakti i tyre i parë me procesin gjyqësor dhe gjatë gjithë këtij procesi, informohen menjëherë për rrjedhën e procesit përfshirë: rolin e fëmijëve viktimë apo dëshmitarë; mekanizmat ekzistues mbështetës për fëmijën viktimë apo dëshmitar; disponueshmërinë e masave mbrojtëse; të drejtat përkatese të fëmijëve viktimë; mundësitë ekzistuese për përfitim të dëmshpërblimit nga kryesi i veprës penale ose nga shteti; disponueshmërinë e shërbimeve shëndetësore, psikologjike, sociale dhe shërbimeve të tjera përkatese; progresin dhe zgjidhjen e çështjes specifike, përfshirë ndalimin, arrestimin dhe mbajtjen në gjendje paraburgimi të të akuzuarit, etj. (shih për më tutje nenin 119)	Prokurori Shtetit Gjyqtari Kompetent	QPS-ja, MV-ja	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijët viktimë të abuzimit dhe keqtrajtimit mund të ofrojnë edhe këshillime
11. Për veprimet e mëtutjeshmë gjyqësore shif pjesën e tabelës së PSV-ve pjesa lidhur me procedurën e Gjykitimit			
12. Vendimi i Gjykatës	Gjykata		
13. Rehabilitimi dhe reintegrimi i Viktimës duke përfshirë edhe involvimin aktiv të institucionit mbështetës pas procedurës gjyqësore sipas nenit 134 të Kodit të Drejtësisë për të mitur: Pas përfundimit të procedurave gjyqësore, personi mbështetës lidhet me organizatat ose profesionistët e përshtatshëm, për të siguruar që fëmijës viktimë apo dëshmitar t'i ofrohet këshillim ose trajtim i mëtejshëm.	Mbrojtësi Viktimave nga Prokuroria e Shtetit Gjyqtari Kompetent	QPS-ja	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijët viktimë të abuzimit dhe keqtrajtimit mund të ofrojnë edhe këshillime psiko-sociale si dhe strehim të përkohshëm (shih listën e plotë të veprimeve të cilat mund të ndërmarrin OJQ-të ofruese të shërbimeve në Kapitullin III Rolet dhe Përgjegjësitë e akterëve të ndryshëm në ofrimin e mbrojtjes fëmijëve viktimë).

## MBROJTJA

Veprimet	Institucioni bartës	Institucioni Mbështetës	Veprimet mbështetëse nga akterët tjerë
1. Është obligim i prindërve, mësuesve, mjekëve, punëtorëve social, mbrojtësve të viktimave dhe kategorive të tjera të profesionistëve, sipas rastit, që të njoftojnë policinë, në rast se kanë bazë të arsyeshme për të dyshuar se fëmija është viktimë e një veprë penale. Personat, më lartë ndihmojnë fëmijën, derisa fëmija të marrë ndihmën e duhur profesionale. Obligimi për të bërë kallëzimin, siç parashikohet në nenin 114 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, e tejkalon detyrimin për fshehtësinë e informacionit, me përjashtim të rastit të konfidencialitetit avokat-klient.	QPS-ja, MV-ja	Mësuesit, mjekët dhe kategoritë e tjera të profesionistëve	OJQ-të ofruese të shërbimeve fëmijë viktimë si dhe të tjerë OJQ të angazhuar në ndihmë viktimave fëmijë.
2. Shërbimet, institucionet ose organizatat që ofrojnë shërbime për fëmijë, marrin masat e përshtatshme me qëllim që personat, të cilët janë akuzuar për një veprë penale, të cilësuar si vepër penale ndaj një fëmije, nuk janë në kontakt me fëmijët.	QPS-ja, Mbrojtësi i Viktimave, Prokurori Shtetit, Gjyqtari Kompetent	QPS-ja, Mbrojtësi i Viktimave	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijë viktimë që ofrojnë strehim për fëmijën viktimë
3. Identifikimi i rasteve të viktimës fëmijë kryhet nga akterët të ndryshëm institucional apo ofruesit e shërbimeve dhe monitoruesit e drejtave të fëmijëve sikurse OJQ-të	QPS-ja, Mbrojtësi i Viktimave, Prokurori Shtetit	OJQ-të në ofrimin e shërbimeve fillestare sikurse strehimi përkohshëm	Identifikimi nga akterët të jashtëm të tjerë sikurse mediat
4. Referimi i rastit të fëmijës viktimë dhe caktimi i menaxherit të rastit kryhet nga ana e QPS-së	QPS-ja	Mbrojtësi i Viktimave, Prokurori Shtetit, Policia e Kosovës	
5. Vlerësimi i rastit si dhe koordinimi i hapave për veprim mëtutje me rastin bëhet në bashkëpunim të ngushtë të QPS-ve më MV-të	QPS-ja, MV-ja	Prokurori Shtetit	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijë viktimë sikurse "Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijë," në Prishtinë përkrahur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (ish-MPMS-ja) në përputhje me mandatin e licencuar dhe financimin e strehimoreve për fëmijë viktimë
6. Ofrimi i përkrahjes së viktimës fëmijë nga QPS-ja duke caktuar kujdestarin ligjor dhe ofrimi i strehimit të përkohshëm si dhe vazhdimi i arsimimit nëse konsiderohet që viktimë nuk është në rrezik	QPS-ja	Mbrojtësi i Viktimave, Prokurori Shtetit	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijë viktimë Institucionet Arsimore
7. Ofrohet përfaqësimi i viktimës fëmijë në polici nga QPS-ja	QPS-ja dhe Mbrojtësi i Viktimave	Prokurori Shtetit	

Veprimet	Institucioni bartës	Institucioni Mbështetës	Veprimet mbështetëse nga akterët tjerë
8. Ndërmirret përpilimi i kërkesës për urdhër mbrojtje sipas rastit	MV-ja, QPS-ja	Prokurori Shtetit	
9. Ofrohet përfaqësimi në gjykatë	MV-ja, QPS-ja	Prokurori Shtetit, Gjyqtari Kompetent	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijë viktimë
10. Inicohet referimi tek akterët tjerë për përkrahje të vazhdueshme të viktimës	QPS-ja, MV-ja	OJQ-të	Institucionet arsimore, Institucionet Shëndetësore
11. Inicohet përpilimi i deklaratës së viktimës	MV-ja	QPS-ja, Prokurori Shtetit	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijë viktimë
12. Hartohet kërkesa për Kompenzimin e Dëmit, njohtimi menjëhershëm i viktimës për mundësinë e kompenzimit (Shih Nenin 62 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës)	MV-ja	QPS-ja, Prokurori Shtetit	
13. Ofrohet reintegrimi dhe rehabilitimi afatgjatë i viktimës fëmijë pas procedurave gjyqësore	QPS-ja	MV-ja	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijë viktimë Institucionet Arsimore Institucionet Shëndetësore

## GJYKIMI

Veprimet	Institucioni bartës	Institucioni Mbështetës	Veprimet mbështetëse nga akterët tjerë
<p>1. Në çdo fazë të procesit gjyqësor, kur siguria e fëmijës viktimit apo dëshmitar gjykohet se është në rrezik, gjyqtari kompetent vendos për marrjen e masave mbrojtëse për fëmijën. <b>Këto masa mund të përfshijnë masat e parapara në Ligjin përkatës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, por duke mos u kufizuar si më poshtë:</b></p> <p>1.1. të shmangët kontakti i drejtpërdrejtë mes fëmijës viktimit ose dëshmitar dhe të akuzuarit, në çdo etapë të procesit gjyqësor;</p> <p>1.2. të kërkohet mbrojtje për fëmijën viktimit apo dëshmitar nga policia ose institucionet të tjera përkatëse dhe të mos bëhet publike vendndodhja e fëmijës;</p> <p>1.3. të merren ose të kërkohet nga autoritetet kompetente marrja e masave të tjera mbrojtëse që mund të gjykojnë të përshtatshme.</p>	Gjyqtari kompetent	MV-ja, QPS-ja	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijë viktima  Institucionet Arsimore  Institucionet Shëndetësore
<p>2. Gjyqtari kompetent siguron që procedurat lidhur me dëshminë e fëmijës viktimit apo dëshmitar, të zhvillohen në një gjuhë që të jetë e thjeshtë dhe e kuptueshme për fëmijën dhe të sigurohet gjykimi në gjuhën e kuptueshme për fëmijën viktimit, përkthyesi si dhe masa të tjera për ndihmë të veçantë.</p>	Gjyqtari kompetent	MV-ja, QPS-ja	
<p>3. Gjykata lëshon një autorizim me shkrim për ekzaminimin mjekësor ose marrjen e ekzaminimeve nga trupi vetëm nëse ekzistojnë arsye të bazuara për të besuar se ekzaminimi ose marrja e një mostre nga trupi është i nevojshëm me prezencën e prindit apo kujdestarit ligjor</p> <p>Në rast të heqjes së drejtës prindërore ose prindit të dyshuar për kryerjen e veprës penale prezencën e prindit nuk lejohet</p>	Gjyqtari kompetent	MV-ja, QPS-ja	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijë viktima  Institucionet Shëndetësore
<p>4. Personi mbështetës caktohet nga gjyqtari kompetent dhe është nga Qendra për punë sociale. Gjyqtari mund të konsultohet edhe me viktimën lidhur me gjininë e personit mbështetës nëse ka preferenca.</p> <p>Çdo intervistë e fëmijës viktimit apo dëshmitar, që kryhet në kuadrin e procesit gjyqësor, bëhet në prani të personit mbështetës.</p>	Gjyqtari kompetent	QPS-ja	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijë viktima
<p>5. Gjyqtari kompetent, që cakton personin mbështetës, monitoron punën e personit mbështetës dhe e ndihmon atë, sipas rastit. Nëse personi mbështetës nuk i kryen detyrat dhe funksionet e tij në përputhje me këtë kapitull, gjykata cakton një person mbështetës zëvendësues pas këshillimit me fëmijën.</p>	Gjyqtari kompetent	QPS-ja	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijë viktima
<p>6. Gjyqtari kompetent mund të caktojë një psikolog ose ekspert relevant për qëllimin e ekzaminimit të zotësisë së fëmijës. Ekzaminimi për zotësinë synon të përcaktojë nëse fëmija është i zoti ose jo për të kuptuar pyetjet që i drejtohen atij në një gjuhë që është e kuptueshme për të, si dhe rëndësinë që të thuhet e vërteta.</p> <p>Gjyqtari kompetent mund të vazhdojë me vlerësimin e zotësisë në bazë të pyetjeve të paraqitura nga prokurori dhe avokati mbrojtës në rast se gjyqtari kompetent vlerëson që ekzaminimi për zotësinë e fëmijës mund të kryhet edhe pa ekspertin prezencën e të cilit nuk mund të sigurohet.</p>	Gjyqtari kompetent	QPS-ja	Psikolog, ekspert relevant të fushës

<p>7. Gjykata siguron që fëmijët viktima apo dëshmitarë të kenë mundësi të presin në ambiente të posaçme pritjeje, të mobiluara në një mënyrë të përshtatshme dhe miqësore për fëmijët, përfshirë lehtësirat për personat me nevoja të veçanta. Ambientet e pritjes, që përdoren nga fëmijët viktima apo dëshmitarë, nuk janë të dukshme ose të lejueshme për personat e akuzuar për kryerjen e një veprë penale.</p>	Gjyqtari kompetent	QPS-ja, MV-ja	
<p>8. Përveç prindërve, kujdestarit dhe përfaqësuesit të autorizuar, apo personave tjerë që caktohen për të ofruar asistencë, gjyqtari kompetent lejon që personi mbështetës ta shoqërojë fëmijën viktimit gjatë gjithë kohës që ai merr pjesë në procedurat gjyqësore, me qëllim reduktimin e ankthit apo stresit.</p> <p>Gjyqtari kompetent informon personin mbështetës se ai/ ajo, si dhe vetë fëmija, mund t'i kërkojnë gjykatës pushim kur fëmija ka nevojë për të.</p> <p>Gjyqtari kompetent mund të urdhërojë largimin e prindërve ose kujdestarit të fëmijës nga seanca kur kjo gjë është në interesin më të lartë të fëmijës</p>	Gjyqtari kompetent	QPS-ja, MV-ja	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijë viktima nëse të caktuar si mbështetës
<p>9. Me kërkesën e fëmijës viktimit apo dëshmitar, të prindërve, kujdestarit, përfaqësuesit të autorizuar, personit mbështetës të tij, të caktuar për të ofruar asistencë ose bazuar në kërkesën e vetë institucionit, gjyqtari kompetent, duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës, mund të urdhërojë një ose më shumë nga masat për të mbrojtur jetën private dhe mirëqenien e fëmijëve viktima dhe dëshmitarë sikurse: ndalimin e zbulimit të identitetit të fëmijut; mospublikimi i informacioneve që zbulojnë identitetin e fëmijut; caktimi i pseudonimit të fëmijut, etj.</p> <p>(Shih për më shumë detaje Nenin 131 të Kodit Drejtësisë për të Mitur).</p>	Gjyqtari kompetent	QPS-ja, MV-ja, Prokurori Shtetit	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijë viktima
<p>10. Gjyqtari kompetent e informon fëmijën viktimit apo dëshmitarin, prindërit, kujdestarin dhe përfaqësuesin e autorizuar të tij për procedurat për të kërkuar kompensim. Pas dënimit të kryesit dhe përveç ndonjë mase tjetër që është marrë kundër tij, gjyqtari kompetent, me kërkesën e prokurorit, viktimës, prindërve ose kujdestarit të tij, apo përfaqësuesit të autorizuar të viktimës, ose bazuar në kërkesën e vetë institucionit, mund të urdhërojë që kryesi i veprës penale të bëjë kthimin ose kompensimin për fëmijën.</p> <p>(Shih Nenin 132 Kodit Drejtësisë për të Mitur)</p>	Gjyqtari kompetent	QPS-ja, MV-ja, Prokurori Shtetit	
<p>11. Gjyqtari kompetent e informon fëmijën, prindërit ose kujdestarin e tij dhe personin mbështetës për rezultatin përfundimtar të gjyqit. Gjyqtari kompetent e fton personin mbështetës që t'i ofrojë mbështetje emocionale fëmijës, që ta ndihmojë atë ta pranojë rezultatin përfundimtar të gjyqit, nëse është e nevojshme.</p>	Gjyqtari kompetent	QPS-ja	OJQ-të ofruese të shërbimeve për fëmijë viktima nëse të caktuar si mbështetës
<p>12. Roli i personit mbështetës pas përfundimit të procedurave gjyqësore (shih më lartë të shtylla mbi Mbrojtjen)</p>			



## ► SHTOJCA 2:

## Mekanizmat dhe ko-ordinimi ndërinstitucional

## Mekanizmat institucional monitorues

1. Gjykatat
2. Ministria përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale dhe punës
3. Departamenti për Politika Sociale dhe Familje
4. Ministria përkatëse e Arsimit dhe Shkencës
5. Ministria përkatëse e Shëndetësisë
6. Ministria përkatëse e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
7. Ministria përkatëse e Administrimit të Pushtetit Lokal
8. Komuna
9. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
10. Drejtoria Komunale për Arsim
11. Drejtoria Komunale e Bujqësisë
12. Zyra e Avokatit të Popullit
13. Inspektorati i Punës
14. Prokurori i Shtetit
15. Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve

## Mekanizmat institucional operacional

1. Inspektorati i Punës
  2. Policia e Kosovës
  3. Inspektorati Komunal
  4. Qendrat për Punë Sociale
  5. Qendrat e Mjekësisë Familjare
  6. Institucionet e kujdesit dytësor dhe tretësor shëndetësor
  7. Qendrat e Shëndetit mendor
  8. Shkollat
  9. Agjencia për zhvillim rural
  10. Agjencia e Pyjeve
  11. Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
  12. Zyrat e Punësimit
  13. Qendrat e Aftësisë Profesionale
  14. Tryezat për Menaxhimin e Rasteve
  15. OJQ-të dhe Strehimoret
- Përgjegjësitë ligjore të agjencive të zbatimit të ligjit, të adaptuara nga Udhëzuesi për menaxhimin e rastit të fëmijëve në punë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Social (Prishtinë, 2020).

## ► BURIMET E CITUARA DHE BURIMET SHITESË:

1. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 16 dhjetor 1966, Kombet e Bashkuara, gjendet në: <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>
2. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 16 dhjetor 1966, Kombet e Bashkuara, gjendet në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cescr.aspx>
3. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, 20 nëntor 1989, Kombet e Bashkuara, gjendet në <https://e.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>
4. Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/34
5. Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e ndryshuar nga Protokollet Nr. 11, 14, dhe 15, 4 Nëntor 1950, gjendet në: [https://www.echr.coe.int/documents/convention\\_sqi.pdf](https://www.echr.coe.int/documents/convention_sqi.pdf)
6. Këshilli i Evropës, Karta Sociale Evropiane, 18 tetor 1961, gjendet në: <https://rm.coe.int/168047e169>
7. Këshilli i Europës në Kosovë, publikimi "Udhëzues cilësie për strehimoret e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje," në [https://www.wave-network.org/wp-content/uploads/Shelter\\_Guideline\\_ALB.pdf](https://www.wave-network.org/wp-content/uploads/Shelter_Guideline_ALB.pdf)
8. Këshilli i Europës në Kosovë "Vlerësimi i Nevojave për zhvillimin e Udhëzuesit të Cilësisë për Strehimoret e DhNG dhe DhF në Kosovë (2019).
9. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 2/14 Janar 2019
10. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008
11. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 17 / 18 tetor 2018, Prishtinë 54 Kodi nr. 06/I-006 i Drejtësisë për të Mitur;
12. Ligji nr. 03/L-212 i Punës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/01, Dhjetor 2010
13. Ligji nr. 2004/32 për Familjen, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 4/01, Shtator 2006
14. Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Familjen, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 3/17, Janar 2019.
15. Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.14/17, Korrik 2019
16. Moduli i Trajnimit për Prokurorë dhe Gjyqtarë hartuar për ILO dhe Akademinë e Drejtësisë nga trajnuesi: Prof/ Ass. Dr. Bedri Bahtiri, Prishtinë 2021
17. Manuali për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Trajtimin e Rasteve të Dhunës në Familje, Pjesa mbi Standartet Ndërkombëtare, Këshilli I Europës, 2021
18. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Konventa e Punës së Detyruar Nr.29, 28 qershor 1930, gjendet në [https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100\\_ILO\\_CODE:C029](https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:C029)
19. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Konventa për Format më të rënda të punës së fëmijëve Nr.182, 1999, gjendet në [https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100::NO:12100:P12100\\_ILO\\_CODE:C182:NO](https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100::NO:12100:P12100_ILO_CODE:C182:NO)
20. Procedurat Standarde të Veprimit për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, në <https://docplayer.net/69548956-Udhezim-mbi-procedurat-standarde-te-veprimit-per-zyren-per-mbrojtje-dhe-ndihme-viktimave.html>
21. Procedurat Standarde të Veprimit për Fëmijë në Forma të Rrezikshme të Punës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2021.
22. Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Menjëhershëm të Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve
23. Udhëzuesi për Menaxhimin e Rasteve të Fëmijëve në Punë," Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 2020.
24. Udhëzuesi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës lidhur me drejtësinë miqësore për fëmijë,"2010, gjindet në <https://rm.coe.int/16804b2cf3>
25. UNWOMEN zyra në Kosovë, Raporti mbi zbatimin e kërkesave të Konventës së Stambollit lidhur me situatën e mar

